

SOLAR TEC 2, SH. P. K.

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp”

Gllanasellë – Drenas

Prishtinë

Janar, 2024

Aplikuesi: **SOLAR TEC 2, SH. P. K.**

Aktiviteti: **“Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4MWp”**

GLLANASELLË – DRENAS

- Njësia Kadastrale P-70315014-00185-4, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-00208-0, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-00209-0, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-01380-1, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-01380-3, ZK GLLANASELLË;

Hartuese e raportit:

Brisilda Gjana

Inxhinier e ambienti / Eksperte e licensuar

Nr. i licencës :82/18/22



brisildagjana011@gmail.com

+ 383 (0)43569468

Investitori:

Solar Tec 2, Sh.P.K.

Ardi Maraj



maraj@luna-tec.de

+ 383 (0)43866044

PERMBAJTJA

1.0	HYRJE	4
2.0	QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT TË VNM.....	4
3.0	KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATIV DHE DOKUMENTACIONI TEKNIK	5
3.1.	Kuadri ligjor dhe rregullativ	5
3.2.	Dokumentacioni teknik	15
4.0.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	15
4.1.	Pozicioni gjeografik dhe gjeomorfologjia e zones.....	15
4.2.	Popullata dhe vendbanimet.....	17
4.3.	Topografia dhe peizazhi	18
4.4.	Trashëgimia Kulturore.....	20
4.5.	Zonat e mbrojtura	22
4.6.	Faktorët klimatik	27
4.7.	Hidrologjia.....	28
4.8.	Ujërat nëntokësore.....	29
4.9.	Cilësia e ajrit	29
4.10.	Tokat dhe cilësia e tyre.....	30
4.11.	Flora dhe fauna.....	33
5.	ANALIZA E ALTERNATIVAVE.....	35
6.	PËRSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT.....	37
6.1.	Të përgjithshme.....	37
6.2.	Lokacioni.....	37
6.3.	Studimet e diellit	43
6.4.	Cikli i zhvillimit të projektit.....	45
6.5.	Përshkrimi i projektit	46
6.6.	Komponentet e projektit	46
7.	NDIKIMET E MUNDSHME TË PROJEKTIT NË MJEDIS	49
7.1.	Ndikimet në mjedis gjatë përgatitjes dhe ndërtimit	49
8.	MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	53
8.1.	Masat e mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së projektit.....	53
9.	PERMBLEDHJE JO TEKNIKE	55
9.1.	Hyrje.....	55
9.2.	Përshkrimi i projektit.....	55
9.3.	Baza ligjore mbështetëse për hartimin e VNM-se.....	56
9.4.	Karakteristikat e mjedisit fizik të zonës së projektit.....	56
9.5.	Ndikimet e mundshme në mjedis të veprimtarisë së projektit	57
9.6.	Masat zbutëse për minimizimin e ndikimeve	57
10.	PLANI I MENAGJIMIT MJEDISOR.....	58
11.	PËRFUNDIMET	58

1.0 HYRJE

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Raporti i VNM) është hartuar në emër të Solar Tec2 shpk si pjesë e procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedor për Projektin “Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp” në Gllanaselle – Drenas .

Kompania Solar Tec 2 shpk., me Numër Unik Identifikues 811955668 është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, ku si biznes primar ka prodhimin e energjisë elektrike.

Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedor si kusht për marrjen e lejes për ndërtimin dhe operimin e parkut solar.

2.0 QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT TË VNM

Raporti i VNM-s hartohet me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së “**Parku Solar - Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp**”, duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku planifikohet të ndërtohet.

Ky raport paraqet gjetjet e procesit të VNM-së të përgatitur për Projektin “**Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp**” dhe ka përcaktuar efektet e Projektit “**Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp**”, në mjedis dhe implikimet e mundshme në hapat e përshkruar si më poshtë:

- Raportin e Studimit për të identifikuar çështjet kryesore mjedisore në një fazë të hershme .
- Studimet mbi gjendjen ekzistuese, për të përcaktuar gjendjen e mjedisit dhe kushtet socio-ekonomike para implementimit të Projektit ;
- Parashikimi i ndikimit të mundshëm në kushtet e gjendjes ekzistuese të Mjedisit të vendosura për shkak të zbatimit të Projektit të propozuar;
- Identifikimi i mënyrave të menaxhimit për të zbutur ose mënjanuar çdo ndikim negativ
- Përgatitja e raportit të VNM që detajon procesin e VNM që është ndërmarrë dhe gjetjet e tij.
- Zhvillimi i një Plani Menaxhimi dhe Monitorimi Mjedor dhe planet shoqëruese që dokumentojnë veprimet e kërkuara për të adresuar ndikimet dhe çështjet mjedisore të projektit, që do të zhvillohen duke ndjekur rekomandimet e bëra brenda këtij raporti;
- Monitorimi i performancës mjedisore të Projektit - që do të ndërmerret gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të Projektit për komunitetin lokal, në lidhje me ndërtimin, operimin dhe demontimin e projektit të propozuar:




Figure 1. Procesi i përgjithshëm i VNM-së

3.0 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATIV DHE DOKUMENTACIONI TEKNIK

3.1. Kuadri ligjor dhe rregullativ

Kosova ka një legjislacion specifik që shtron nevojën për Vlerësimin e Ndikimit në mjedis. Ligji i vitit 2009 për mbrojtjen e mjedisit parashikon disa kërkesa, përfshirë kërkesën për të kryer një VNM dhe për të marrë një leje mjedisore përpara fillimit të projektit.

Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.

Tabela 1. Legjislacioni Kosovës për një VNM

Legjislacioni	Përmbledhje e ligjit	Lidhja me projektin
<p>LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS</p>	<p>1. Ky ligj ka për qëllim:</p> <p>1.1. Të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private;</p> <p>1.2. Të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private;</p> <p>3. Garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.</p> <p>2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Europian dhe Këshillit e dt.16 prill 2014 e cila ndryshon Direktivën 2011/92/EU mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private.</p>	<p>VNM për Projektin do t'i paraqitet MMPHI për kontroll, shqyrtim dhe miratim.</p>
<p>LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT</p>	<p>1. Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore përmbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>2. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës mesjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.</p> <p>Ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>	<p>Duhet të kryhet VNM-ja dhe të merret leja mjedisore përpara se të fillohet një Projekt. Ligji përcakton kërkesat monitoruese për të identifikuar ndikimet e projektit gjatë ndërtimit dhe fazës operacionale.</p>

**LIGJI NR. 08/L-025 2020
PER MBROJTJEN E
AJRIT NGA NDOTJA
(SHFUQIZON LIGJIN
Nr. 03/L- 160**

1. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.

2. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit mjedisor; Direktivën 2004/107/EC për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor dhe Direktivën 2016/2284/EC për tavanet e emisioneve kombëtare për disa ndotës atmosferikë, e cila ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC.

Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave fizikë dhe juridikë, aktivitetet e të cilëve në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e ndotin ajrin si dhe ndaj të gjitha autoriteteve publike dhe private të cilat kryejnë veprimtarinë e monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimin e emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme dhe verifikimin e sistemit matës për matjen e vazhdueshme të emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme.

Neni 4

Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit

1. Masat të cilat ndërmerren me qëllim të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe shtresës së ozonit, nuk duhet të dëmtojnë përbërësit tjerë të mjedisit, cilësinë e jetës së brezave të sotëm dhe të ardhshëm dhe nuk duhet të jenë në kundërshtim me rregullat nga fusha embrojtjes në punë dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

2. Masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit duhet të jenë në harmoni me objektivat afatgjate të BE të përshkruara në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane, Ekonominë Qarkore e koncepte tjera, të cilat sigurojnë rritjen ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Në VNM janë propozuar masat zbutëse për të kufizuar ndikimin e aktiviteteve të projektit.

<p>LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA (2008)</p>	<p>Neni 1</p> <p>Qëllimi</p> <p>1.1. Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis.</p> <p>1.2. Ky ligj do të ofrojë bazë për krijimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanërisht ato rrugore, hekurudhore, ajrore, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineria mobile dhe burimet tjera të ndotjes dhe bezdisjes së mjedisit nga zhurma.</p> <p>Neni 2</p> <p>Fushëveprimi</p> <p>2.1. Zhurma e dëmshme për shëndetin e njeriut nga ky ligj, është çdo zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara, të cilat do të përcaktohen me akt të veçantë normativ, shikuar nga aspekti kohor dhe nga vendit ku buron zhurma, në mesin ku njerëzit punojnë dhe jetojnë.</p> <p>2.2. Ky ligj do të zbatohet për zhurmën mjedisore ndaj të cilës njerëzit ekspozohen në zonat e ndërtuara, “zonat e veçanta të planit hapësinor”, në parqet publike ose zonat tjera të qeta të aglomerateve, zonat e qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve, zonave dhe ndërtesave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmës.</p> <p>2.3. Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me masat mbrojtëse nga zhurma të cilat e detyrojnë Kosovën, sipas kontratave ndërkombëtare, konventave dhe normave tjera në transportin ajror, hekurudhor, dhe atë rrugor.</p>	<p>Gjatë aktivitetit të projektit Park Fotovoltaik në Gllanasellë do të përdoren makineri të rënda dhe kamionë. Është me rëndësi për procesin e VNM-së që me makineritë që bëjnë zhurmë të punohet gjatë orëve të ditës. Pajtueshmëria me këtë ligj do të konsiderohet si një dokument përkatës për sugjerimin e masave zbutëse dhe menaxhimin brenda fushës së procesit të VNM-së.</p>
--	--	---

	<p>2.4. Aktin nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni, e nxjerr ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me pëlqimin paraprak të ministrit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ministrit të Ministrisë për Shëndetësi.</p>	
<p>LIGJI Nr. 03/L-233 PËR MBROTJEN E NATYRES(09.11.2010)</p>	<p>Neni 1/ Lënda</p> <p>1. Me këtë ligj rregullohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe vlerave të sajë.</p> <p>2. Natyra në kuptim të këtij ligji paraqet gjithë larminë biologjike dhe peizazhore.</p> <p>Neni 2/ Qëllimi</p> <p>1. Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë dhe veçanërisht:</p> <p>1.1. mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;</p> <p>1.2. përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;</p> <p>1.3. vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;</p> <p>1.4. pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;</p> <p>1.5. sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;</p>	<p>Ne raport do te jepen te gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e natyrës nga ndikimi i aktivitetit te projektit ne fjalë, duke siguruar kështu efekte minimale ne natyre dhe mbrojtjen e saj .</p>

	<p>1.6. sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;</p> <p>1.7. parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;</p> <p>1.8. mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së;</p> <p>1.9. ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).</p>	
<p>LIGJI NR. 05/L-085 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE (21.07.2016)</p>	<p>Neni 1/ Qëllimi</p> <p>1. Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë rregulla dhe masa për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikastë saj.</p> <p>2. Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën Nr. 2009/72/EC, lidhur me rregullat epërbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.</p> <p>Neni 2/ Fushëveprimi</p> <p>Fushëveprimi i këtij ligji përfshin rregullat e përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar të energjisë elektrike, si pjesë e tregut rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, si dhe përcakton rregullat që kanë të bëjnë me qasjen e palëve në rrjet, obligimet për shërbime publike, të drejtat e konsumatorëve dhe kushtet e konkurrencës.</p>	<p>Projekti do të veprojë në përputhje me standardet mjedisore kombëtare .</p>

<p>LIGJI PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË Ndryshohet/Plotësohet nga <u>LIGJI NR. 08/L-123 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME RACIONALIZIMIN DHE VENDOSJEN E VIJAVE LLOGARIDHËNËSE TË AGJENCIVE EKZEKUTIVE</u></p>	<p>Neni 1/Qëllimi</p> <p>Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në vijim për racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhëse të agjencive ekzekutive:</p> <p>1.1. Ligjit nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;</p> <p>1.2. Ligjit nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë.</p> <p>NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 06/L-029 PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE SIGURI BËRTHAMORE</p> <p>Neni 2 paragrafi 3 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:</p> <p>Ky Ligj përcakton statusin, detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për mjedis, përgjegjësinë për të komunikuar me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare relevante dhe përgjegjësitë për të arritur objektivat e përcaktuara në këtë ligj.</p>	<p>Projekti do të veprojë në përputhje me standardet mjedisore kombëtare.</p>
<p>LIGJI NR.08/L-087 PËR RREGULLIMIN E TOKËS rregullon dhe ploteson NR.04/L-040 (30.08.2022)</p>	<p>Neni 1/ Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.04/L-040 për Rregullimin e Tokës dhe harmonizimi i tij me Ligjin për Kundërvajtje.</p> <p>Neni 2/ Fusha e Zbatimit</p> <p>Me këtë ligj përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve që janë kompetente për rregullimin e tokës, procedurat për rregullimin e tokës, planifikimi, financimi dhe zbatimi i këtij procesi.</p>	<p>Përgjegjës për koordinimin e procedurave të zbatimit dhe kryerjen e kompensimit gjatë zbatimit të projektit në këtë rast rregullohen mes pronarit të tokës dhe investitorit të projektit.</p>
<p>LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.</p>	<p>Neni 1/ Lënda e rregullimit sipas ligjit 02/L-26</p>	<p>Projekti është i detyruar të informojë autoritetet lokale për çdo dëmtim të tokës bujqësore nga veprimtaria e tij.</p>

<p>02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE</p>	<p>Me këtë ligj përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>Sipas ligjit 08/L-112</p> <p>Neni 1</p> <p>Qëllimi : Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe harmonizimi i tij me Ligjin për Kundërvajtje.</p>	<p>Autoritetet vlerësojnë dëmin dhe kërkojnë që përdoruesi i tokës të kthejë në gjendjen e mëparshme gjendjen e tokës bujqësore. Janë propozuar masa zbutëse.</p>
<p>UDHEZIM ADMINISTRATIV 04/2022 PER LEJE MJEDISORE</p>	<p>Neni 1 /Qëllimi</p> <p>1. Ky Udhëzimi Administrativ ka për qëllim parandalimin dhe kontrollin e ndotjes nga aktivitetet industriale, po ashtu përcaktimin e procedurës së aplikimit, shqyrtimit dhe procesit të vendimmarrjes për leje mjedisore.</p> <p>2. Ky Udhëzim Administrativ është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën 2010/75/BE për emisionet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).</p> <p>Neni 2/ Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për të gjitha institucionet, personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në procedurën e aplikimit, lëshimit dhe zbatimit të lejes mjedisore.</p>	

3.2. Dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, përpos eksperiencës profesionale, janë shfrytëzuar;

- PVsyst – Simulation report
- Certifikata e biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit të ngastrave kadastrale
- Kontratat për shfrytëzim të ngastrave kadastrale.
- Matje gjeodezike në terren

4.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Për hartimin e Raportit të VNM, karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit ku do të ndërtohet **“Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp”** janë bazë themelore. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë pas vëzhgimeve dhe vrojtimeve në terren si dhe duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë zonë.

Analiza e mirëfilltë e lokacionit dhe tërësisë hapësinore të projektit duke bërë një hulumtim të thellë dhe të saktë të potencialeve ekzistuese të mjedisit ku do të zhvillohet projekti është element thelbësorë në përgatitjen e një Raporti të VNM. Hulumtimi i gjendjes ekzistuese bëhet me qëllim që të zhvillohet projekti, të vlerësohen mundësitë e efekteve negative dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.

4.1. Pozicioni gjeografik dhe gjeomorfologjia e zones

Territori i komunës së Drenasit, shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit dhe është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Komuna e Drenasit ka një sipërfaqe prej 275,63 km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë. Pjerrësia e terrenit është 10 – 35 %. Gjerësia gjeografike ku shtrihet komuna është 42° 68”, gjatësia gjeografike është 20° 92”.

Territori i komunës së Drenasit nuk është uniform; Në përgjithësi është i përbërë nga zona të rrafshëta, kodrinore dhe malore. Në pjesën qendrore shtrihet lugina e Drenicës, në lindje të së cilës shtrihen Çiçavica, Goleshi dhe Blinaja, ndërsa në perëndim Caraleva, bjeshkët e Berishës dhe Kosmaçi. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër”.


E veçanta tjetër e kësaj treve është miniera dhe shkëmborja e “Feronikelit”, si dhe disa gurore. Nëpër këtë komunë kalon lumi Drenica me dy degët e sajë që vijnë nga drenica e kaltë dhe drenica e ulët. Uji i lumit shfrytëzohet për nevojat e ujitjes së tokave bujqësore. Kjo komunë, në pikëpamje të ndërlidhjes tokësore lidhet më pjesët tjera të Kosovës më anë të hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë – Bushat (Komoran)-Pejë, dhe rrugët ndër komunale Shalë- Lipjan dhe Bushat-Drenas-Skenderaj.



Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Drenasit në Kosovë(ish Glogoc)

Pedologjia dhe gjeologjia - Tokat në këtë komunë janë mjaft heterogjene nga aspekti i krijimit, vetive fiziko- kimike, përkatësisë tipologjike, pjellorisë potenciale, problemeve melioruese etj. Tokat në territorin e Komunës së Drenasit sipas përbërjes pedologjike janë të përfaqësuara nga: tokat e murrme në shtresa kompakte, tokat e mesme të kuqërremtë, tokat e kuqe, tokat smonicë, tokat rendezinë, tokat ranker, tokat pseudogleje, tokat e livadheve, tokat diluviale dhe tokat aluviale etj.

Gjeologjia – Drenasi për nga struktura e tokës i takon Bazenit të Drenicës, që bën pjesë në Bazenet e Kenozoikut. Ndërtohet nga shkëmbinjë të Paleozoikut, me përbërje vullkanogjeno sedimentare të Triasikut. Në Qyqavicë, janë prezent edhe metamorfitet e Shtimës dhe ata permo-tirasik të Jezercit. Terreni është i përfshirë me thyerje të shumta tektonike, si atë të Baicës. Drenasit, Kozmaqit,




Harta 2: Harta gjeologjike e territorit të Komunës së Drenas

4.2. Popullata dhe vendbanimet

Nga të dhënat e paraqitura të regjistrimeve të popullsisë rezulton që numri i popullsisë në Komunën e Drenasit nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 42,354 banorë. Në bazë të kësaj rritjeje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare, del se mesatarisht në qytet popullsia ka shënuar rritje prej rreth 672 banorë në vit.

Përderisa ka rritje paralele në qytet si dhe vendbanimet tjera kur shikohen si vlera në %, por duke i analizuar numrat e banoreve si njësi – numri i banorëve në vendbanimet tjera të komunës së Drenasit është dukshëm më i madh se rritja e numrit të banorëve në qytet të Drenasit. Kështu në qytetin e Drenasit nga viti 1948 deri në vitin 2011 numri i banorëve ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 8,228 banorë duke u rrit me më shumë se 10 fish sa ishte në vitin 1948, pra vendbanim me vetëm 558 banorë. Sipas regjistrimit të fundit, Komuna e Drenasit ka një popullsi prej mbi 60,000 banorëve.

Fenomeni i urbanizimit te qyteteve që vërehet në shumicën e qyteteve në Kosovë, sidomos në periudhën e pasluftës, pra migrimi i brendshëm fshat-qytet - nuk duket të jetë aq i theksuar ne Komunën e Drenasit.



Harta 3: Harta e vendbanimeve në bazë të madhësisë (burimi: Plani Lokal i Veprimit Ne Mjedis 2020-2024)

4.3. Topografia dhe peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishe në relacionin projekt –mjedis. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive, e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishtëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturore, sociologjike dhe subjektive.

Territori i komunës së Drenasit nuk është uniform; në përgjithësi është i përbërë nga zona të rrafshëta, kodrinore dhe malore. Në pjesën qendrore shtrihet lugina e Drenicës, në lindje të së cilës shtrihen Çiçavica, Goleshi dhe Blinaja, ndërsa në perëndim Caraleva, bjeshkët e Berishës dhe Kosmaçit.

Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër”.




Figure 3. Paraqitja skematike topografike e zones se projektit

Ndërtimi gjeologjik i komunës së Drenasit i takon Fushëgropës së Kosovës, e cila është krijuar gjatë rrudhosjes së oligomiocenit. Territori i komunës i kesaj komune karakterizohet me një ndërtim të ndërlikuar gjeologjik që shfaqet me prezencën e shkëmbinjve me përbërje e moshë gjeologjike të ndryshme.

Territori i komunës është i ndërtuar prej sendimenteve Neogjenë, ndërsa anët e rrafshnaltës, në territorin e maleve të ulëta janë të rrethuara prej pjesëve të forta të shkëmbinjve të Paleozoikut, të vjetërsisë Jurasike dhe të shkumësit. Pjesa e ulët e rrafshnaltës është e përbërë prej tokave të punës, e rrallë prej livadhevedhe kullosave. Pjesët malore kanë kryesisht sendimente me përbërje acidike.

Formacionet e paleozoikut shtrihen në pjesën jugperëndimore, gjegjësisht në Malin përfaqësohen nga rreshpet kristalore të paleozoikut, ndërsa në pjesët e tjera të pellgut përfaqësohen nga mermeri, graniti, gabro etj.

Formacionet e triasikut shtrihen në veri të malit Golesh dhe përfaqësohen nga shiste argjilore, ranorë të metamorfozuar, ranorë kuarcorë dhe konglomerate. Në pjesën e malin të Çyçavicës, përfaqësohen nga argjila, filitet, kuarciti. Në Çikatovë dhe Vasilevë përfaqësohen nga gëlqerorë të mermerizuar, gëlqerorë brekqorë, gëlqerorë bituminozë etj.

Formacionet e jurasikut kanë një shtrirje në formë brezi në drejtimin veri-jug dhe gjenden kryesisht në malin Drenica.

Formacionet e kretakut në pellgun e Drenicës përfshijnë kretakun e sipërm turonian që përfaqësohet nga masivi i gëlqerorëve ranorë dhe gëlqerorëve rudistë dhe shtrihen kryesisht në pjesën veriore të Çikatovës, Verbocit etj. Këta gëlqerorë kanë ngjyrë të murrme të shndritur, të verdhë, të murrme me kristalizim të lartë. Po ashtu, kemi kretakun e sipërm senonian që shtrihet në zonën e Kosmaçit.

Sedimentet pliocenike të neogjenit shtrihen përgjatë luginës së Drenicës ku rëra dhe argjila ka pjesëmarrje më të madhe. **Sedimentet e kuaternarit** shtrihen kryesisht përgjatë lumit Drenica dhe degëve të sajë. Paraqiten në formë të depozitimeve të terracave lumore deluvione dhe aluvione. Këto depozitime janë rezultat i shpëlarjes sipërfaqësore të materialit shkëmbor të alteruar.

Shkëmbinjtë ultrabazikë përfaqësohen nga serpentinitet dhe paraqiten në malin Golesh dhe në pjesë të ndryshme të pellgut si, në malin Berisha, Malin Kosmaç, Gllanasellë, Gradicë etj.

Shkëmbinjtë bazikë janë gabrot (më të rrallë), dhe paraqiten në pjesën jugore dhe lindore të pellgut Drenica.

4.4. Trashëgimia Kulturore

Trashëgimi kulturore është çdo gjë që konsiderohet e rëndësishme për të përcjellë në gjenerata të ardhshme. Është pasqyrim i mënyrës së jetesës që është zhvilluar nga komuniteti dhe e përcjellë nga një brez në brezin tjetër. Në Kosovë, trashëgimia kulturore është një ndër elementet më të rëndësishme dhe pjesë përbërëse e mjedisit jetësor dhe përbën një nga pikat kryesore për zhvillimin e turizmit. Sipas “Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027” trashëgimia definohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Tabela në vijim përfshin numrin e objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive (nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme)

Kategoritë	Numri
Trashëgimia arkitekturale	11
Trashëgimia arkeologjike	7
Peizazhet kulturore	0
Zonat e veçanta të mbrojtura	0
Gjithsej	18

Tabela 2. Trashëgimia kulturore dhe shtrirja hapësinore, 2018

Nga të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore në Komunën e Drenasit, trashëgimia arkeologjike përfshin 7 asete ndërsa ajo arkitektuale përfshin 11 objekte. Duke u bazuar në informata nga kjo Komue, prej 11 objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshin lista e përkohshme, 1 prej tyre është në gjendje të mirë, 1 në proces të ndërtimit, 3 në gjendje mesatare, 5 të dëmtuar dhe 1 fare nuk ekziston.

Tabele 3. Trashëgimia arkeologjike/Lokalitet arkeologjik

Nr.	Emërtimi	Periudha	Vendi	Nr. Unik në databazë
1	Gërmadhat e kishës së vjetër në Fushticë	Mesjetë	Fushticë, Drenas	715
2	Kalaja Antikë dhe mesjetare në Vërboc	Antikitet i Vonë, Mesjetë	Vërboc, Drenas	2934
3	Qyteza e vogël dhe e madhe në Vuçak	Antikitet i Vonë	Bajicë , Drenas	720
4	Kalaja e Llapushnikut	Parahistori, Antikiteti i Vonë	Llapushnik, Drenas	3608
5	Tuma e vetmuar në Llapushnik	Parahistori	Llapushnik Drenas	723
6	Fortifikata parahistorike “Gradina” në Çikatovë të Vjetër	Parahistori	Çikatovë e Vjetër, Drenas	3616
7	Kalaja - Çuka e Godancit	Parahistori	Godanc, Drenas	3706

https://dtk.rks-gov.net/tkk_hyrje.aspx

http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf

Burimi: Aprovimi i Listës së përkohshme të trashëgimisë Kulturore MKRS

4.5. Zonat e mbrojtura

Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës në mesin e të cilave janë edhe asetet e trashëgimisë natyrore të komunës së Drenasit.

Tabela 4: Lista e zonave të mbrojtura në Drenas

Kodi	Emërtimi i Zonës/ objektit	Sipërfaqja/ ha	Kategoria sipas IUCN	Viti i marrjes ne mbrojtje	Përshkrimi i shkurtër i vlerave
MN_017	Shpella e Baicës	0.11	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_018	Shpella e Gllanasellës	0.5	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_024	Trungjet e rrënjës (Quercus robur) në Nekovc	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_025	Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Quercus robur) në Negroc	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_026	Trungjet e shpardhit në Negroc	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_027	Shpella e Kishnarekës	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_028	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Krajkovë	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_029	Guri i Gradinës në Llapushnik	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
MN_030	Burimi i ujit mineral, në Poklek	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_031	Trungjet e dushkut - Gjashtë lisat (Quercus sp.) në Likoshan	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_032	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Tërstenik	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_033	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoshan	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_034	Guri i plakës në Dobroshec	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik



Figura 4. Paraqitja hartografike e zonave të mbrojtura në Komunën e Drenasit

4.5.1 Asetet e tashegimise natyrore

MONUMENTET NATYRORE ne komunën e Drenasit listohen si me poshte:

1. SHPELLA E KISHNAREKËS - Shpella e Kishnarekës është me karakter Gjeomorfologjik që nënkupton shpellën dhe hapësirën gëlqerore në cilën ndodhet duke përfshirë edhe zonën buferike prej 25 m. Monumenti i natyrës ka një sipërfaqe prej 2 ha. Shpella ndodhet në vendi ne quajtur Rudina në pronësi shoqërore të fshatit Kishnarekë. Sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.



Shpella E Kishnarekës


2. TRUNGU I QARRIT (QUERCUS CERRIS L.) KRAJKOVË - Tungu i Qarrit gjendet në fshatin Krajkovë dhe identifikohet si monument i natyrës i karakterit botanik që është në Listën e Monumenteve Natyrore të Mbrojtura (*Quercus cerris*)



Tungu i Qarrit në Krajkovë


3. GURI I GRADINËS NË LLAPUSHNIK - Sipas të dhënave që posedon Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Natyrore, në këtë hapësirë mund të hasen këto lloje të botës shtazore: Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Ujku (*Canis lupus*), Ariu i murrmë (*Ursus Arctos*), Vjedulla (*Meles Meles*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri (*Lepurus europeus*), Sqardhi, Derri i egër (*Sus strofa*) etj. Sipas të dhënave të popullatës lokale dhe të gjahtarëve në këtë lokalitet më herët janë hasur edhe Macja e egër (*Felis Silvestris*) dhe Kaprolli (*Capreolus capreolus*), mirëpo kohëve të fundit këto lloje nuk mund të gjenden më në këto hapësira.

Nga llojet e shpendëve përveç një numri të madh të llojeve të zogjve këngëtarë, në këtë lokalitet gjendet edhe Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), Hutë (*Buteo buteo*), Gjeraqina (*Accipiter gnetilis*), Thëllëza, Petriti, Skifteri (*Falco sp*), Grigja, Laraska, Pëllumbi i egër (*Columba livia*) etj. Po ashtu në këtë lokalitet hasen edhe disa lloje të zvarranikeve si psh. Gjarpi i gurit –nepërka (*Vipera amodytes*), Hardhuca e verdhë (*Lacerta viridis*), Hardhuca e pyllit (*Lacerta gracilis*) dhe Kokezoza. Nga ujë tokësorët mund të hasen bretkosa e pyjeve (*Rana sp*), Picërraku (*Salamndraatra*)




Guri i Gradinës.

4. TRUNGU I DUSHKUT NË LIKASHAN (6 LISAT) - Trungu i dushkut në Likashan si monument i natyrës i karakterit botanik nënkupton trungun e dushkut me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 5m rreth projeksonit të kurorës. Zona e mbrojtur përfshinë sipërfaqen prej 5 ari. Trungu ka lartësinë e kërcellit prej 20m me perimetër prej 4 m (në lartësi 1 m) me diametër të kurorës 18 m. dhe vjetërsi afër 200 vjet.



6 lisat

5. GURI I PLAKËS - Monument i natyrës nënkuptohet shkëmbi dhe sipërfaqja prej 5 ari e cila e rrethon shkëmbin, duke përfshirë edhe zonën buferike prej 10 m, në ngastrën në të cilën ndodhet territorin e Komunës së Drenasit, në vendin e quajtur: “Gollusha”.




Guri i Plakes


6. LIQENI I VASILEVËS - Gjeneron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim të ekoturizmit ku mund të organizohet peshkimi dhe ecja në natyrë. Në këtë mënyrë ofrohet mundësia që vizitorët të shijojnë bukuritë e natyrës dhe të gjejnë pushim në brigjet e freskëta të liqenit e sidomos në ditët e nxehta të verës.



LIQENI I VASILEVËS

7. PISHAT E KAMENICËS FSHATI GLLOBAR - Ky park me një sip. 59.4ha gjeneron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim të ekoturizmit ku mund të organizohet dhe ecja në natyrë, freski ne këtë ambient pushime etj.





Harta 4. Shtrirja e Aseteve të trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë natyrore

4.6. Faktorët klimatik

Komuna e Drenasit ka kryesisht klimë të mesme kontinentale me ndikim të klimës së ndryshueshme mesdhetare, ngaqë gjendet ndërmjet dy baseneve më të mëdha të Kosovës dhe ndahet prej tyre me male, lartësia e të cilave arrin mbi 1000m. Në anën lindore të Drenicës gjendet fusha e Kosovës ku mbizotëron klima kontinentale, ndërsa në anën perëndimore gjendet fushëgropa e Dukagjinit, ku mbizotëron klima e mesme kontinentale me ndikim të klimës mesdhetare. Kështu, në këtë territor dimrat janë të shkurtër dhe relativisht të ftohtë.

Reshjet në formë bore janë dukuri normale gjatë dimrit. Gjatë kohës kur fryn era veriore, në këtë rajon sjell kryesisht kohë të kthjellët të shoqëruar me acar, ndërsa kur fryn era jugore sjell mot të butë dhe shkrinë borën. Vera në këtë rajon është e nxehtë dhe relativisht e thatë. Pranvera dhe vjeshta kryesisht dallohen si sezona kalimtare.

Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, kurse shumica e temperaturave vjetore është 3.869 °C. Muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vjetëzimit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm. Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore.





Figura 5: Klimadiagrami i Komunës së Drenasit bazuar në të dhënat klimatologjike të Komoranit

Nga ky klimadiagram shihet se reshjet më të pakta janë gjatë muajve të verës, sidomos në muajin gusht, ku po ashtu janë temperaturat më të larta. Reshje më të larta ka në muajin nëntor dhe janar. Ndërsa temperaturat më të ulëta janë në muajin dhjetor dhe janar. Komuna e Drenasit ka potenciale për shfrytëzimin e disa prej resurseve klimatike e sidomos të erës, meqë në territorin e saj shtrihen disa hapësira të larta malore si Malet e Berishës, Kosmaqi, Çiçavica, Goleshi etj. Që karakterizohen me potencial të erës. Zonat e tilla në të ardhmen mund të shfrytëzohen për prodhim të energjisë nga era.

4.7. Hidrologjia

Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Drenasit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pellgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc te mali Cërralevë. Drenica që nga Drenasi e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m³/s. Drenica ka dy degëzime: Njëra vije nga Drenica e nëltë e cila si u tha më lartë buron në mallet e Carralevës e tjetra nga Drenica e ulët që buron në mallet e fshatit Verbofc. Në territorin e komunës së Drenasit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës.

Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3, rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër-Lepenc”.



Harta 5. Rrjeti hidrografik

4.8. Ujërat nëntokësore

Është evident ekzistimi i ujërave nëntokësoreë gati në tërë territorin e këtij rajoni që dokumentohet me numër të madh të puseve me të cilat shërbehen një numër i madh i vendbanimeve. Ujërat nëntokësoreë nuk janë aq të forta, përpos në disa vende, për të mund të jenë furnizues kryesorë të ujit, mirëpo ekzistimi i tyre është shumë i madh në pikëpamje të furnizimit me ujë, ndërsa në rajonet rrafshinore është element kufizues në fundimin dhe hidroizolimim e objekteve ndërtimore.

4.9. Cilësia e ajrit

Ajri - Cilësia e ajrit në Drenas monitorohet përmes stacionit në Drenas nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, i cili raporton në Agjencinë për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Stacioni i vendosur në Drenas është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin urban. Matjet behën vetëm në sfondin urban e

jo në tërë territorin e komunës. Nga të dhënat për matjen e përqendrimit SO₂, CO, NO₂, dhe O₃ shihet se nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave mesatare vjetore (VML) në stacionin monitorues për vitin 2017. Është vërejtur se gjatë sezonës vjeshtë-dimër-pranverë kishte tejkalime të përqendrimit të pluhurit në formë të PM₁₀ dhe PM_{2.5} që janë rezultat i aktiviteteve të Feronikelit, transportit rrugor dhe amvisërive, të cilat gjatë sezonit të ngrohjes përdorim lëndë djegëse që lirojnë emisione të cilat shkaktojnë ndotjen e ajrit.

Emisionet në ajër nga Feronikeli- Përmbajtja e metaleve të rënda në xehen fillestare, si Fe-hekur, Ni-Nikel, Cu-Bakër, Cd-Kadmijum, Cr-Krom, As-Arsenik, Pb -Plumb etj. dhe proceset metalurgjike që e shoqërojnë procesin e tërësishëm e karakterizojnë Feronikelin ndotës të kategorisë A (sipas Kriterëve për VNMBEZH dhe BB). Emisionet në ajër lirohen veçanërisht nga furrat rrotulluese, furrat elektrike, konvertori dhe ngrohtorja. Matjet nuk bëhen në mënyrë të vazhdueshme, por vetëm kohë pas kohe. Sipas një projekti të financuar nga UNDP për nivelin e ndotjes së ajrit në zonën Drenasit janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara kryesisht gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2015 në të katër lokacionet ku janë marrë mostrat: Çikatovë e vjetër, Çikatovë e Re, Gllobar dhe Lagja e Feronikelit.

4.10. Tokat dhe cilësia e tyre

Aktualisht Kosova, nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulshmërisë së tokave është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. Është konstatuar se ka pasur rritje të sipërfaqeve të zonave urbane, zonave industriale e komerciale dhe atyre për nxjerrjen e mineraleve, kurse ka pasur humbje të sipërfaqeve për kategoritë e tokave bujqësore, kullotave dhe pyjeve, ndërsa që sipërfaqet e zonave të gjelbra dhe atyre rekreative kanë mbetur të njëjta. Rreth 7.35 % e sipërfaqeve të tokës në Kosovë janë identifikuar me intensitet eroziv shumë të fortë, 16.1 % të fortë, 35.4 % të mesëm, 24.55% të dobët, 10.1% shumë të dobët dhe 6.5% pa erozion. Bujqësia, konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokave bujqësore, që vije si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kimikateve tjera për trajtimin e tokave. Po ashtu edhe industritë aktive dhe ato të vjetra janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kimikateve që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

Kërkesat e shfrytëzimit të tokave në vend në baza vjetore janë në rritje e veçanërisht në sferën e përdorimit ekonomik si për sektorin e bujqësisë, ndërtimit, rrugëve, turizëm, rekreacion dhe infrastrukturë tjetër (menaxhim të mbeturinave), impiante për trajtimin e ujërave etj. Shfrytëzimi dhe përdorimi i tokave pa një plan menaxhues gjithëkombëtarë mbetet sfida kryesore e menaxhimit të qëndrueshëm të tokave. Menaxhimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e tokave nga ndotja është standard i cili duhet përmbushur nga të gjitha nivelet e institucioneve lokale, qendrore dhe nga sektori privat. Madje edhe politika e BE ka si fokus dhe prioritet qasjen e integruara për planifikimin dhe menaxhimi e përdorimit të tokës. Aktivitetet e Agjencisë së Mjedisit të Evropës janë të përqendruar në monitorimin, dokumentimin dhe vlerësimin e modelit hapësinor, shtrirjes dhe dinamikës së përdorimit të tokës dhembulesës së tokës në Evropë. Kjo dinamik e monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes së shfrytëzimit dhe përdorimit të tokës duhet të aplikohet edhe në Kosovë.


Sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) Drenas per vitin 2020- 2028 , Tokat në këtë komunë janë mjaft heterogjene nga aspekti i krijimit, vetive fiziko-kimike, përkatësisë tipologjike, pjellorisë potenciale, problemeve melioruese etj.

Tokat në territorin e Komunës së Drenasit sipas përbërjes pedologjike janë të përfaqësuara nga: tokat e murrme në shtresa kompakte, tokat e mesme të kuqërremtë, tokat e kuqe, tokat smonicë, tokat rendezinë, tokat ranker, tokat pseudogleje, tokat e livadheve, tokat diluviale dhe tokat aluviale etj.

Tabele 5. Sipërfaqja e llojeve të tokave sipas përbërjes pedologjike në ha dhe %
(Burimi: Harta pedologjike, Baza e hidroekonomisë e KSA të Kosovës)

EMRI	SIP_HA	%
TOKË E KUQE	304	1.1
TOKË E KUQËRREMTË	6807	24.7
TOKË E MURRME KOMPAKTE	4474	16.2
TOKË E LIVADHEVE	588	2.1
TOKË ALUVIALE	601	2.2
TOKË DELUVIALE	923	3.3
TOKË PSEUDOGLEJ	4087	14.8
TOKË RANKER	323	1.2
TOKË RENDZINE	2106	7.6
TOKË SMONICE	7350	26.7

Sa i përket mbulshmërisë së sipërfaqeve të tokave pjesën më të madhe e përbëjnë pyjet, tokat e punueshme dhe zonat tjera të sipërfaqeve bujqësore.



Harta 6. Harta e mbulueshmërisë së sipërfaqes së tokës në Komunën e Drenasit

Tokë e murme në shtresat kompakt dhe tokë e mesme e kuqërremtë – këto toka krijohen mbi substrate acidike, të varfra me baza, mbi shkëmbinj të kompaktë dhe sedimente të shkapërderdhura. Karakterizohen me diferencim të dobët të profilit, ndërsa përmbajnë pak argjilë, prandaj edhe janë të lehta për punë. Shtrihen kryesisht në pjesën qendrore të Komunës së Drenasit.

Toka e mesme e kuqërremtë gjendet në shumë pjesë të territorit të Komunës, pellgut si atë perëndimore, qendrore dhe lindore.

Tokat e kuqe kanë një përhapje të vogël në komunën e Drenasit dhe shtrihen në Gradicë.

Toka smonicë shtihen kryesisht në pjesën qendrore të Komunës së Drenasit.

Tokat rendzina në komunën e Drenasit gjenden kryesisht në Sankoc, Zabel i Epërm, Komoran, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Tërstenik, Verboc, Shtuticë dhe Gradicë, Krasmirovc.

Toka rankeri – këto toka llogariten si toka malore, po mund të ndodhë që të paraqiten edhe në terrenet e rrafshëta. Shfrytëzohen për livadhe dhe kullota e më pak për kultivimin e drithërave. Shtrihen kryesisht në Kishnarekë, Komoran dhe Zabel i Ultë.

Toka pseudogleje – janë të formuara si rezultat i lagies së tepërt të horizontit sipërfaqësor nga ujërat stagnuese. Përhapjen më të madhe në Drenas e kanë në Llapushnik, Dobroshevc, Grabovc, Godanc e Çikatovë.

Tokat e livadheve shtrihen në Fushticë të Poshtme, Komoran, Zabel i Ulët dhe Korroticë e Ulët. Tokat e këtilla janë kryesisht livadhe.

Tokat deluviale shtrihen në Negroc, Llapushnik, Krajkovë, Sankovc, Fushticë e Epërme, dhe Dobroshevc.

Tokat aluviale kryesisht përgjatë dy anëve të lumenjve Drenica dhe Verbovc dhe më së shumti shfrytëzohen për kultivimin e kulturave bujqësore si gruri dhe misri, por dhe perimet.

4.11. Flora dhe fauna

Flora dhe vegjetacioni i territorit të Komunës së Drenasit - Territori i komunës së Drenasit zë një vend të rëndësishëm në Kosovë nga aspekti floristik dhe vegjetativ. Sipas të dhënave që disponojmë, territori i komunës së Drenasit i takon Rajonit Eurosiberiko – Amerikanoverior i cili përfshinë viset kontinentale të vendit, e që ndahen ndërmjet rajoneve kufitare mediterane nga njëra anë dhe majave më të larta të masiveve malore të cilat i takojnë regjionit Alpiko – Nordik nga ana tjetër. Ky regjion, prezantohet me dy provinca fitogjeografike të cilat janë:

1. **Provinca Mezike**, e cila përfshinë shpatet e Malit të Çyçavicës në kuadër të së cilës hyjnë pyjet lëvorbardha dhe pyjet lëvorzeza të brezit malor (montan) dhe paramalor (submontan) e që në këtë territor paraqitet konkretisht me pyje të bungut dhe shkozës (*Quercus* – *Carpinetum Rud.*) dhe pyjet kodrinore dhe malore të ahut (*Fagetum montanum Rud.*), dhe në bazë të kësaj që u përmend më lart, mund të konstatohet se në territorin e Drenasit janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile; të prezantuara në bashkësi të ndryshme të cilat ndërmjet tyre dallohen në bazë të përbërjes floristike si pasojë e kushteve të ndryshme ekologjike.

- Në territorin e drenasit janë prezente këto bashkësi (asociacione) pyjore: *Ass. Carpinetum orientalis scardicum*, *Krasniqi* (Bashkësia e shkozë së zezë) *Ass. Quercetum farnetto – cerris scardicum*, *Krasniqi* (Bashkësia e shpandhit dhe qarrit), e përhapur kryesisht në lartësi mbidetare deri në 750 m,
- *Ass. Quercetum montanum*, *Çer. et Jov.* (Bashkësia e dushkut malor), në lartësi mbidetare prej 630 – 960 m, e përfaqësuar kryesisht nga bunga (*Quercus petraea*),
- *Ass. Fagetum montanum Rud.* (Bashkësia e ahut).

2. Në zonën përreth **Gurit të Gradinës** në të gjitha ekspozicionet është prezentë fitocenoza *Fagetum Montanum* me rreth 47 lloje që kanë një shtrirje mjaft të gjerë përreth monumentit. Në bazë të kësaj pasqyre floristike dhe vegjetative të territorit të Drenasit mund të konstatohet se: territori i Drenasit ka florë dhe vegjetacion (sidomos në hapësirat rreth vendbanimeve) dhe se në shumë lokalitete të territorit të Drenasit duhet të bëhen intervenime pozitive drejt normalizimit të gjendjes natyrore duke bërë pyllëzimin me llojet adekuate.

Fauna në territorin e Drenasit - Si rezultat i aktiviteteve antropogjene e sidomos ato gjatë shndërrimit të hapësirës natyrore në territor agrikor, industrial apo territor për banim disa lloje shtazore të cilat kanë ekzistuar në këto zona janë zhdukur ose zhduken. Lloje të cilat janë zhdukur kohë më parë nga këto terrene janë: dreri, dhia e egër, pulëlegra etj.

Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe te këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre. Llojet të cilat ende hasen në territorin e kesaj komune janë:

- ariu (*Ursus arctos*),
- ujku (*Canis lupus*),
- dhelpra (*Vulpes vulpes*),
- qelbësi i rëndomtë,

- derri i egër (*Sus scrofa*),
- vjedulla (*Meles meles*),
- ketri (*Sciurus vulgaris*),
- sqarhi (*Martes foina*),
- vidra,
- lepuri (*Oryctolagus cuniculus*),
- disa lloje të brejtësve të vegjël,
- gjeraqina,
- skifteri i përhimtë,
- petriti (*Falco tinnunculus*),
- kukuvajka,
- huti (*Bubo bubo*),
- harabeli,
- thëllënza (*Alectoris graeca*),
- pëllumbi i egër,
- kumria,
- disa lloje të korbave,
- çukapiku (*Dendrocopus major*),
- qyqja (*Cuculus canorus*),
- lauresha,
- borësi,
- rosat e egra (*Anser anser*),
- patat e egra (*Anas platyrhynchos*),
- lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë),
- breshka e kënetave,
- breshka e pyjeve,
- hardhuca e përhime, h
- ardhuca e mureve,
- hardhuca e gjelbër,
- neperka,
- gjarpëri i larmë,
- gjarpëri i ujit (johelmues),
- picrraku (*Salamandra atra*),
- tritoni (*Triturus vulgaris*),
- bretkosa e gjelbërt,
- bretkosa dregëzore,
- krapu (*Cyprinus caprio*),
- fildishi,
- skobusi,
- shumë lloje të pakurrizorëve etj.

Në zonën përreth Gurit të Gradinës, sipas të dhënave që posedon IKMN në këtë hapësirë hasen këto lloje shtazore: 8 lloje gjitarësh, ndërsa dy lloje të tjera të gjitarëve janë zhdukur, 9 lloje shpendësh, 4 lloje zvarranikësh, 2 lloje ujë-tokësor.

Viteve të fundit nga territori i komunës së Drenasit janë raportuar disa gjetje të reja të insekteve ujore për faunën e Kosovës. Nga rendi i inskteve Plecoptera 6 lloje (*Nemoura anas*, *Nemoura peristeri*, *Nemoura asceta*, *Nemoura vinconi*, *Protonemura beaumonti* dhe *Brachyptera macedonica*) janë gjetja të reja për faunën e Kosovës të mbledhura në Bjeshkët e Berishës. Keto lloje kanë përhapje të kufizuar dhe janë shumë të rralla.

5. ANALIZA E ALTERNATIVAVE

Ky kapitull paraqet analizën e alternativave, respektivisht arsyeshmërin për projektin e propozuar të energjisë diellore në kapacitet të instaluar prej 70.4 MWp. Ai gjithashtu diskuton teknologjitë e ndryshme dhe opsionin e vetëm të vendëndodhjes. Përderisa kërkesa për energji vazhdon të rritet, Kosova po kërkon burime alternative të energjisë, projekti ka arsyeshmëri të mjaftueshme. Arsyetimi i lokacionit - përcaktimi për lokacionin në fjalë është bërë për shkak të diellit të fortë, kohëzgjatjës së diellosjes si dhe disa kritereve tjera teknike dhe socio-ekonomike kanë kontribuar në përcaktimin në këtë vendndodhje. Përzgjedhja e lokacionit është bërë nga aplikuesi i projektit. Ato janë të renditura si në vijim:

- ✓ Energjia e prodhuar nga impianti mund të shpërndahet nëpërmjet një linje ekzistuese të transmetimit 220 kV e cila kalon nëpër vendndodhjen e projektit;
- ✓ Topografia e vendit është ideale (e rrafshët/ me pjerrtësi jo të theksuar rrafshët në të gjithë sipërfaqen e saj me përjashtim të disa pjesëve);
- ✓ Vendndodhja ndodhet larg zonave kryesore të banimit, dhe nuk paraqitet nevoja të bëhet zhvendosja e popullsisë, andaj nuk priten ndikime të theksuara në komunitetin e zonës.

Kompania "SOLAR TEC 2" Sh.P.K. i është drejtuar Komunës së Drenasit lidhur me për dhënien e pëlqimit paraprak (njoftimit) për ndërtimin e parkut solar me kapacitet 70.4 MWp për lokacionin e cekur në kapitujt e mësipërm. Komuna e Drenasit, respektivisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, përmes shkresës zyrtare njofton se Komuna e Drenasit nuk ka ndonjë interes për këto prona, sepse ato janë private dhe se nuk është paraparë ndonjë projekt infrastrukturor sipas planeve komunale (Shkresa 08-Nr. 070-64338, date 19.12.2022).

Përfitimet e Projektit - përfitimet e mundshme të projektit përfshijnë ndër të tjera:

- ✓ Rritja e prodhimit të energjisë elektrike - kur të jetë funksional, projekti pritet të gjenerojë rreth **959,000 MWh** energji elektrike në vit dhe të rrisë kapacitetin gjenerues të Kosovës;
- ✓ Rritja e kualitetit të furnizimit me energji elektrike për përdorim shtëpiak dhe industrial;
- ✓ Mundësia e ngritjes profesionale për punëtorë - inxhinierë dhe teknikë vendas që do të ndjekin programe aftësim dhe trajnimi për të menaxhuar impiantin fotovoltaiq;
- ✓ Mundësitë lokale të punësimit - gjatë periudhës së ndërtimit e shumica e të cilëve do të jenë nga zonat përreth;
- ✓ Reduktimi i varësisë nga gjenerimi i energjisë nga lëndë djegëse fosile – kjo do të rezultojë në frenimin e emetimeve
- ✓ Vlerë investive e projektit rreth **45.660.000,00 Euro**. Analizat Tekniko - Financiare janë dhënë më detajisht në Aneksin 7 të këtij raporti.

Analiza e alternativave – janë vlerësuar skenarët alternativë për përmbushjen e objektivave të qeverisë dhe propozuesit në ofrimin e prodhimit të energjisë së pastër. Është shqyrtuar alternativat në lidhje me llojin, shkallën dhe vendndodhjen e projektit. Opsionet e shqyrtuara ishin: **Mos bëj gjë** dhe opsioni i zgjedhjes së lokacionit.

Opsioni 1: Situata aktuale (opsioni "mos bëj asgjë"

Alternativa pa veprim supozon se projekti nuk do të kryhet. Kjo do të rezultonte në mungesën e energjisë elektrike në vend si dhe do të vazhdohej me përdorimin e burimeve tradicionale të lëndëve djegëse fosile me të njëjtin intenzitet, që e gjithë kjo rezulton me efekte të mëdha negative në mjedis. Si përfundim, opsioni "mos bëj asgjë" nuk konsiderohet një alternativë e zbatueshme ose e pranueshme.

Opsioni 2: Opsioni alternativ i vendndodhjes për ndërtimin e impiantit solar

Edhe pse mund të ketë ndikime mjedisore për shkak të punimeve, p.sh. zhurma, ndotja e ajrit, pluhuri, shkatërrimi i habitatit, por për shkak të natyrës së punimeve këto ndikime pritet të jenë minimale dhe

vetëm gjatë fazës fillestare të ndërtimit dhe jo gjatë operimit.

Kjo zone është zgjedhur nga investitori pas një sere studimesh terreni e analizash gjeodezike e cila rezulton në një zonë ideale për zhvillimin e projektit.

Nga ana tjetër, impianti fotovoltaik do të ofrojë siguri më të madhe energjetike për Republikën e Kosovës si dhe do të vendosë Komunën e Drenasit në hartën energjetike, do të sigurojë furnizim të qëndrueshëm, cilësor dhe të siguri të vendit për të prodhuar energji elektrike dhe do të ndihmojë në arritjen e objektivave të strategjisë energjetike të Kosovës. Gjithashtu, energjia diellore është energjia më e pastër e disponueshme, nuk ndot dhe nuk emeton karbon. Gjithashtu vlen për tu përmendur mundësia e punësimit për komunitetin lokal gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të Projektit Solar.

METODOLOGJIA E PUNËS

Metodologjia e punës e përdorur për të vlerësuar ndikimin në mjedis gjatë ndërtimit u krye në disa faza:

a) Informacion bazë që nënkupton identifikimet siç janë:

- Popullsia ekzistuese me karakteristika demografike;
- Burimet bazë të ndikimeve në mjedis;
- Karakteristikat e tokës, topografia dhe peizazhi në lokacionin e planifikuar;
- Klima e vendndodhjes me të dhëna meteorologjike;
- Cilësinë e ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë;
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- Madhësia dhe lloji i ndotjes;
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës;
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar;
- Vlerësimi i shpërndarjes hapësinore të lëndës ndotëse.

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura në mjedis

vlerësimi i ndikimit në lokacionet e planifikuara gjatë ndërtimit të Projektit Solar

6. PËRSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT

6.1. Të përgjithshme

Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026¹ përcakton objektivat themelore të Qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e mjedisit, furnizimin e sigurt dhe cilësor të konsumatorëve, shfrytëzimin eficient të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtitëshme, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit natyror dhe krijimin e vendeve të reja të punës që ndërlidhen me sektorin e energjisë. Ndër objektivat e kësaj strategji është edhe plotësimi i caqeve dhe obligimeve në efikasitet të energjisë, burime të ripërtitëshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.

Kosova është zotuar në përbushjen e caktuar të kursimit prej 9% nga konsumi i gjithëmbarshtëm i energjisë, cak i vendosur sipas Direktivës 2006/32/EC të BE-së. Gjithashtu ka marrë obligimet për zbatimin e politikave të reja të BE-së që burojnë nga Direktiva Evropiane 2012/27/EC për efikasitetin e energjisë. Kosova sikurse edhe palët tjera kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ka detyrime për implementimin e direktivave evropiane për mjedisin dhe kjo do të mbetet një prej objektiveve strategjike të sektorit të energjisë në Kosovë.

Si anëtare e Komunitetit të Energjisë, Kosova është e obliguar që të arrijë caqet mandatore për BRE-të për vitin 2020 të përcaktuara dhe aprovuara nga Këshilli i Ministrave në vitin 2012. Për Kosovën është paraparë 25 % e pjesëmarrjes së BRE-ve në konsumit bruto të energjisë, ashtu siç është përcaktuar edhe në Planin Nacional të Veprimit. Por një target edhe më i lartë prej 29.47% është caktuar në Udhëzimin Administrativ në vitin 2013. Pjesëmarrja e BRE-ve në bruto konsumin e energjisë në Kosovë për vitin 2015 ka qenë 19.7%. Në bazë të caqeve indikative për rritjen e efikasitetit të energjisë, që Kosova i ka miratuar në bazë të obligimeve nga Traktati për Komunitetin e Energjisë, është përpiluar Plani i Kosovës për Efikasitetin e Energjisë (PKEE) 2010 - 2018. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka kërkuar nga vendet nënshkruese të traktatit të bëjnë adaptimin e metodologjisë së harmonizuar të Komisionit Evropian (KE-së) për vlerësimin e kursimeve të energjisë dhe të përdorin atë për vlerësimin dhe verifikimin e kursimeve të energjisë së vendeve të tyre. Kjo metodologji e adoptuar në vitin 2011 nga vendet nënshkruese të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, në kuadër të masave për implementimin e efikasitetit të energjisë, parasheh edhe instalimin e sistemeve diellore për ngrohjen e ujit sanitar.

6.2. Lokacioni

Projekti “**Parku Solar 70.4 MWp**” do të zbatohet në Komunën e Drenasit, më saktësisht në zonën kadastrale të GLLANASELLËS me keto karakteristika gjeografike;

Gjerësia: 42° 68”

Gjatësia: 20° 92”

Lartësia: 653 m

Hapësira e projektit përfshinë ngastrat kadastrale si në vijim:

- Njësia Kadastrale P-70315014-00185-4, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-00208-0, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-00209-0, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-01380-1, ZK GLLANASELLË;
- Njësia Kadastrale P-70315014-01380-3, ZK GLLANASELLË;

¹https://me.rks-gov.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_-.pdf




Figure 4. Paraqitja skematike e zonës me objektet përcjellëse- linja energjetike ekzistuese




Figure 5. Pamje e ngastrave kadastrale ku do të zhvillohet projekti




Figure 6. Pamje e ngastrave kadastrale ku do të vendosen Panelat Solar dhe Trafostacioni



Figure 7. Pamje nga fshati Gllanaselle

E gjithë hapësira e planifikuar për zhvillimin e projektit kap një sipërfaqe prej 77 ha. Ngastrat e mësipërme janë tokë e klasit të pestë dhe të gjashtë, në pronësi private, për të cilat investitori ka krijuar raporte kontraktuale për shfrytëzim të tyre (kontratë për qiramarrje). Rreth zones së projektit nuk ka zona të banuara, si dhe infrastruktura rrugore paraqitet mjaft e mirë duke e bërë të favorshme transportin dhe levzijen e mjeteve në këtë lokalitet. Me poshtë paraqitet harta rrjetit rrugor në zonen e shënuar si në figure.



Harta e rrugëve në komunën e Gllgocit



Foto 1, 2 &3 . Pamje nga zona e projektit ne terren

6.3. Studimet e diellit

Parametri kryesor për vlerësimin e burimit diellor ose krahasimin e dy vendndodhjeve të ndryshme është rrezatimi diellor global. Rrezatimi horizontal global për Kosovën varion nga 1,200 kWh/m² për pjesët malore të vendit, deri në 1,500 kWh/m² në pjesën jugore afër Gjakovës. Këta numra janë në përputhje me vendet fqinje. Zonat me potencial më të lartë të energjisë diellore janë në pjesën ultësirë të vendit, përkatësisht në pjesën perëndimore dhe qendrore. Në tabelën e mëposhtme (Tabela 7) tregohet rrezatimin mujor dhe vjetor në planin horizontal, në kWh/m², për disa lokacione në Kosovë. Siç shihet të dhënat për Malet e Sharrit janë ekstrem minimale.

Tabela 7. Rrezatimi mujor dhe vjetor-këndi optimal(kWh/m²)

Muaji	Gjakovë	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	PK Malet e Sharrit
Janar	46.06	43.33	44.22	41.41	23.39
Shkurt	59.22	58.58	57.71	57.99	29.69
Mars	103.44	101.90	99.65	103.37	56.78
Pri	144.65	138.45	139.89	139.32	93.32
Maj	182.81	174.22	174.60	176.27	129.71
Qershor	201.79	192.81	189.91	195.04	161.08
Korrik	222.12	211.89	210.63	214.86	169.54
Gush	199.11	188.79	187.89	190.52	126.47
Shtator	131.52	126.92	126.30	129.62	74.14
Tetor	90.04	88.71	86.58	89.06	40.22
Nëntor	55.38	54.48	52.97	55.06	25.82
Dhjetor	39.27	38.70	37.23	37.31	20.81
Totali	1,475.40	1,418.77	1,407.57	1,429.83	950.96

Në vijim po paraqesim edhe në përmes hartës, rrezatimin diellor të Kosovës (burimi: SOLARGIS)




Figura 6. Harta e rrezatimit diellor të Kosovës (burimi: SOLARGIS)

Nga harta e mësipërme, na tregon qartë se lokacioni i përzgjedhur është mjaft i përshtatshëm për ndërtimin e impianteve për energji të sipërtrishme, respektivisht parkut solar në fshatin Gllanaselle.

Megjithëse rrezatimi në rrafshin horizontal është parametri kryesor kur krahason vendet e ndryshme për vlerësimin e prodhimit të energjisë nga sistemet diellore, rrezatimi në rrafshin e anuar luan një rol më të rëndësishëm. Në mënyrë që të maksimizohet rendimenti i energjisë, mbledhësit diellorë zakonisht vendosen në një kënd optimal dhe orientohen në jug, gjë që në përgjithësi rrit absorbimin e rrezatimit diellor me rreth 15-20%, krahasuar me rrafshin horizontal. Zgjidhje të tjera teknike përfshijnë vendosjen e moduleve shpinë-me-shpinë në një orientim lindje-perëndim për të rritur rendimentin gjatë orëve jashtë pikut. Në çdo rast, vendosja e saktë është një çështje e optimaleve financiare dhe projektimit të një impianti FV.

Prodhimi i energjisë lidhet drejtpërdrejt me rrezatimin diellor në një vend specifik; megjithatë, burimi diellor nuk është faktori i vetëm në zgjedhjen e vendndodhjeve, as në vlerësimin e potencialit teknik. Faktorët teknikë, të tillë si konfigurimi i terrenit, përdorimi i tokës, zonat e mbrojtura etj. luajnë rol të madh në zvogëlimin e zonave të përshtatshme për impiantet diellore. Potenciali teknik, sa i përket MW të instaluar, për impiantet diellore të montuara në tokë vlerësohet në lidhje me zonën e përshtatshme të disponueshme.

6.4. Cikli i zhvillimit të projektit

Cikli i zhvillimit të projektit të propozuar përbëhet nga tre faza:

- faza e ndërtimit,
- faza e funksionimit dhe
- faza e dekomisionimit.

Faza e ndërtimit mund të fillojë vetëm nëse aplikuesi merr pëlqimin mjedisor dhe lejet përkatëse të ndërtimit nga autoritetet kompetente dhe nëse një marrëveshje për blerjen e energjisë nënshkruhet një marrës i licencuar i energjisë për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti i propozuar. Faza e ndërtimit përfshin të gjitha aktivitetet e nevojshme për ndërtimin e objektit PV diellor dhe infrastrukturës përkatëse. Pasi të fillojë, ndërtimi mund të marrë deri në 24 muaj për të përfunduar.

Faza e operimit do të fillojë me përfundimin e fazes së ndërtimit, vënien në punë dhe testimin e objektit PV diellor dhe lidhjen me rrjetin. Ai do të përbëhet nga tre aktivitete kryesore: gjenerimi i energjisë elektrike nga burimet e energjisë diellore, ruajtja e energjisë elektrike në sistemet e baterive dhe mirëmbajtja e objektit diellor PV (si zëvendësimi ose pastrimi i paneleve PV ose riparimet e infrastrukturës mekanike dhe elektrike).

Objekti i propozuar diellor PV pritet të gjenerojë energji elektrike nga burimet e energjisë diellore për të paktën 25 vjet. Nevoja dhe afati kohor i fazes së çmontimit do të konfirmohet gjatë fazes së funksionimit të impiantit PV diellor. Ekzistojnë dy mundësi për shqyrtim në fund të fazes operative:

- Opsioni 1: impianti PV diellor mund të ri-energizohet, d.m.th. aplikanti do të përdorë të njëjtin vend dhe do ta zëvendësojë me komponentë më të rinj;
- Opsioni 2: impianti diellor PV mund të çaktivizohet, d.m.th. të gjithë komponentët e infrastrukturës do të hiqen (modulet, strukturat e montimit, themelet e gardheve, rrugët, kanalet etj) dhe do të riciklohen aty ku është e mundur dhe zona do të rehabilitohet në gjendjen e saj natyrore të fazës para ndërtimit;

Opsioni 1 mund të përcaktohet vetëm në fund të fazës operative 20 vjeçare, e cila bazohet në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë midis Prodhuesit të Pavarur të Energjisë dhe autoriteteve të energjisë. Nëse kërkohen procedurat e dekomisionimit (opsioni 2), toka duhet të rehabilitohet dhe të kthehet në gjendjen para ndërtimit. Dekomisionimi, procedurat do të përfshijnë heqjen e paneleve diellore dhe konstruksionit metalik mbajtës. Meqenëse konstruksioni mbajtës metalik është vetëm i ngulur. Kur ai të heqet toka mbetet e pastër dhe mund të vazhdojë të përdoret si tokë bujqësore. Vetëm pjesa ku do të ndërtohet trafostacioni kryesorë dhe pjesa e pajisjeve furnizuese dhe kontrolluese ka pjesë të betonit të cilat duhet të heqen dhe të kthehen në tokë bujqësore. Këto procedura do të jenë në përputhje me kërkesat e PMM-së dhe legjisllacionit apo udhëzimeve të tjera përkatëse. Një plan dekomisionimi do të përpilohet në fund të fazës operative 20-vjeçare për të përcaktuar procedurat që

duhen ndjekur për zbatimin e opsionit 1 ose opsionit 2.

6.5. Përshkrimi i projektit

Aplikanti propozon të prodhjë energji elektrike nga burimet e energjisë diellore duke përdorur panele fotovoltaike. Energjia e prodhuar nga keto panele llogaritet afersisht 70.4 MWp. Ose ndryshe një prodhim energjie vjetore prej 95.6GWh. Për sa i përket alternativave të teknologjisë së energjisë diellore, vetëm teknologjia fotovoltaike është e përshtatshme për zonën e propozuar. Projekti në tërësi përbëhet nga komponentët kryesorë të mëposhtëm:

- ✚ Instalimi i strukturave montuese metalike;
- ✚ Montimi i paneleve diellore;
- ✚ Montimi i inverterëve dhe lidhja e paneleve me inverterët;
- ✚ Lidhja e të gjithë sistemit me nënstacionin;
- ✚ Ndërtesa e operimit dhe mirëmbajtjes;
- ✚ Rugët hyrëse;
- ✚ Rugët e brendshme;
- ✚ Rrethimi i hapësirës;
- ✚ Porta e kontrollit të aksesit;
- ✚ Shtëpiza e rojeve të sigurisë;

6.6. Komponentet e projektit

6.6.1 Strukturat montuese

Strukturat e montimit do të jenë hekur i zinkuar për vendosje fikse të paneleve. Do të instalohen dy lloje strukturash, me 4 rreshta pjerrësia e moduleve 22°, ai i moduleve: 0 ° (Jug).



6.6.2 Modulet fotovoltaike

Modulet PV përbëhen nga shumë qeliza fotovoltaike të lidhura paralelisht për të rritur rrymën dhe në seri për të prodhuar një tension më të lartë. Moduli është i mbështjellë me xham të temperuar (ose ndonjë material tjetër transparent) në sipërfaqen e përparme, dhe me një material mbrojtës dhe të papërshkueshëm nga uji në sipërfaqen e pasme. Skajet janë të mbyllura për izolim ndaj motit dhe shpesh ka një kornizë alumini që mban gjithçka së bashku në një njësi të montueshme. Në pjesën e pasme të modulit ka një kuti kryqëzimi, ose tela, duke siguruar lidhje elektrike.

Karakteristikat e moduleve PV

- 6.6.2.1 Qelula gjysmë monokristaline PERC, 650 Wp:
- 6.6.2.2 Numri i përgjithshëm i paneleve: 108300 njësi
- 6.6.2.3 Modulet me tolerancë të fuqisë: pozitive
- 6.6.2.4 Kornizë alumini
- 6.6.2.5 Xham diellor 3.2 mm
- 6.6.2.6 Garancitë:
- 6.6.2.7 12 vjet garanci produkti
- 6.6.2.8 25 vjet garanci prodhimi: fundi i vitit 12 me efikasitet >90, fundi i vitit 25 me efikasitet >80%.

6.6.3 Invertorët

Një invertor është një pajisje kondicionimi i energjisë që përdoret në sistemet elektrike për të kthyer tensionin DC dhe rrymën DC në tension AC dhe rrymë AC. Ato lidhen drejtpërdrejt me grupin fotovoltaik (PV) (në anën DC) dhe, aty ku janë të lidhura në rrjet, me rrjetin elektrik (në anën AC), dhe konverton energjinë DC të prodhuar nga grupi në energjinë AC të kërkuar nga rrjeti ose përdoruesi i fundit. Në këtë projekt do të përdoren invertorë rreshtorë (String invertor), me fuqi nominale dalëse AC 330 kW. Numri i përgjithshëm i invertorëve: 190 njësi, me efikasitet 98.2%.



6.6.4 Nënstacioni

Nënstacioni 20/220 kV/kV do të ndërtohet mbrenda kufirit të parkut solarë. Edhepse mbrenda kufirit të pronës ku do të ndërtohet parku solarë kalon linja 400 kV, prodhimi i energjisë elektrike nga ky park solarë nuk do të vendoset në këtë linjë por në stacionin shpërndarës 220 kV që ndodhet në afërsi rreth 2,2km nga vendi ku ndodhet stacioni kryesorë i këtijë projekti. Sipas informatës së dhënë nga KOSTT në stacionin shpërndarës 220 kV ndodhet një fushë e lirë rezervë për hyrje apo dalje të energjisë elektrike.

6.6.5 Transformatorët

Do të ketë transformatorë të vegjël që energjinë elektrike AC të marrur nga inverterët do ta transferojnë në energji AC të nivelit 20 kV. Do të jenë 19 trafostacione të tilla, pra për çdo 10 inverter ndërtohet një trafostacion që do të ketë fuqi 3.3 MVA. Më tutje transformimi do të vazhdoj në trafostacionin kryesorë 20/220 kV. Këtu pra do të përshtatet me tensionin ku do të dërgohet energjija e prodhuar.

7. NDIKIMET E MUNDSHME TË PROJEKTIT NË MJEDIS

Energjia solare, duke qenë energji e rinovueshme, përbën një burim të qëndrueshëm energjie, në ndryshim nga ajo e përfitur nga djegia e naftës, gazit apo qymyrit, por edhe ajo hidroelektrike. Megjithëse energjia solare klasifikohet në burimet e rinovueshme të energjisë, pasi nuk shpenzon resurse natyrore, ndërtimi dhe funksionimi ka ndikime në mjedis të cilat duhen analizuar në mënyrë specifike. Ndikimet mund të ndahen në ndikime gjatë ndërtimit dhe ndikime gjatë funksionimit.

7.1. Ndikimet në mjedis gjatë përgatitjes dhe ndërtimit

7.1.1 Ndikimet në tokë

Faza përgatitore/parandërtimeve - Aktivitetet e pastrimit të lokacionit dhe përgatitjes së terrenit (pastrimi i bimësisë, shkurreve, drunjëve aty ku mund të ketë, ndërtimi i rrugëve dhe kullimit) do të rezultojnë në humbjen e mbulesës bimore (barëra dheshkurre) dhe shtresa e sipërme e tokës që mund të çoj në erozionin e tokës.

Faza e ndërtimeve – Gjatë ndërtimit do të bëhet ngjeshja e tokës si dhe ndikimet në tokë kryesisht si rezultat i punimeve të gërmimit në disa seksione ku do të vendosen veçanërisht kanalet kabllore. Punimet tokësore (gërmimet) përvendin ku do të vendoset nënstacioni do të jenë të vogla dhe të kufizuara brenda vend- ndërtimit. Këto punime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në topografi, tokë dhe gjeologji. Gërmimi për tubacionin e transmetimit do të përfshijë gërmimin e tokës, vendosjen e kabllave dhe rimbushjen e tokës së gërmuar dhe ngjeshjen e saj. Dheu i gërmuar do të vendoset përkohësisht në buzë të kanalit të gërmuar dhe tubat do të vendosen në kanal mbi shtratin e rërës.

Gjithashtu në kablo dhe rreth tyre do të mbushet me rërë, dhe më pas pjesa tjetër e kanalit do të mbushet me tokë të gërmuar e cila do të ngjeshët. Dimensionet e kanalit varen nga topografia.

Ngritja e kampit të Kontraktorit mund të shkaktojë ndikim të pakëndshëm nëse aspektetpërkatese të funksionit të tij nuk trajtohen siç duhet si: menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, mirëmbajtja e makinerive, asgjësimi i materialeve dhe sigurimi i ujit të pijshëm.

Derdhjet apo rrjedhjet aksidentale vajrave dhe lubrifikantëve mund të rezultojnë në ndotjen e tokës dhe shkatërrimin e habitateve. Masat kundër derdhjes së naftës pritet të vendosen nga kontraktori. Mundësia e shfaqjes së ndikimeve është mesatare, ashpërsia është e moderuar duke marrë parasysh masat për zbutjen e ndikimit dhe kontrollin që duhen vendosur, dhe kohëzgjatja është afatshkurtër. Prandaj, niveli i përgjithshëm i rrezikut të ndikimit është i moderuar.

Gjatë fazës së operimit - Gjatë fazës operacionale nuk priten ndikime mjedisore pasi vetë sistemi operativ i parkut është i kompjuterizuar dhe gjithçka bëhet automatikisht pa nevojën e ndërhyrjes së stafit, përveç rasteve të jashtëzakonshme. Gjatë operimit, mirëmbajtja vjetore kryhet nga staf profesional dhe kjo bëhet dy herë në vit, me qëllim zgjatjen e jetëgjatësisë dhe inspektimin nëse ka filluar korrozioni apo dëmtimi i kabllave.

Faza e çmontimit - Aktivitetet e çmontimit që mund të kenë ndikim në tokë përfshijnë derdhjen aksidentale të kimikateve si lubrifikantëve dhe nafta. Mundësia e ndikimit është e mesme, dhe ashpërsia është e moderuar dhe afatshkurtër. Prandaj, niveli i përgjithshëm i rrezikut është i moderuar.

7.1.2. Ndikimet në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore

Gjatë fazës së ndërtimit - Me qenë se zona e projektit nuk përfshin nga asnjë lumë në afërsi të tij, mund të thuhet se ky projekt nuk ka asnjë ndikim në ujërat sipërfaqësore.

Niveli i ujërave nëntokësore është më i thellë se thellësia e gërmimit dhe për këtë arsye nuk parashikohet që ujërat nëntokësore të 'ndikohen' gjatë fazës së ndërtimit të parkut diellor pasi gjithçka që pritet të ndërtohet është mbi tokë.

Një ndikim i mundshëm mund të vijë gjithashtu nga ndërtimi dhe mirëmbajtja e vendit të kontraktorit, transporti, mirëmbajtja e makinës dhe trajtimi i karburantit dhe lubrifikantit. Kërkesat për kontraktorin e kantierit përshkruhen në seksionin mbi ndikimet në topografi, gjeologji dhe dhera. Nëse një ngjeshje e

mirë e tokës në kanal nuk ndodh pas instalimit të tubacionit, kjo mund të ndikojë në kullimin e ujërave sipërfaqësore gjatë shirave.

Gjatë fazës së operimit - mund të ketë shkarkime minimale nga pastrimi tremujor i moduleve fotovoltaike. Ujërat e zeza do të mund të dërgohen në një pellg nga ku do të ripërdoren. Rrjedhja aksidentale e vajrave nga transformatori mund të ndodh gjatë funksionimit të linjës së transmetimit dhe nënstationit, gjë që do të shkaktonte kontaminim të trupave ujqorë sipërfaqësor aty pranë. Transformatorët e nënstationit zakonisht vendosen brenda zonave të sigurta dhe të papërshkueshme me një kapacitet depozitimi prej 100% vaj rezervë. Ndikimi i mundshëm në ujërat sipërfaqësore gjatë fazës së funksionimit është i papërfillshëm.

Gjatë fazës së funksionimit nuk do të ketë ndikime në ujëra nëntokësore pasi projekti nuk arrin të preke në thellësi në tokë as gjatë ndërtimit as gjatë operimit.

7.1.3. Ndikimet në kualitetin e ajrit

Faza parandërtimeve/përgatitore - Burimet e mundshme të emetimeve gjatë fazës para ndërtimit/përgatitore janë: pastrimi, rrafshimi, gërmimi dhe vendosja e kantierit të ndërtimeve, rrugët për komunikim në impiant, pikat për magazinimin e materialeve me ç'rast vie deri te gjenerimi i pluhurit dhe grimcave që shkaktohen nga angazhimi kamionëve të mëdhenj (NO_x, SO_x, PM), si dhe nga gjeneratorët dhe kompresorët. Pajisjet e ndërtimit dhe transporti i materialeve mund të ndikojnë potencialisht në rrjedhën e trafikut në rritjen e emetimeve të automjeteve, kohëzgjatja e ndikimit do të jetë afatshkurtër, gjasat klasifikohen si mesatare dhe niveli i rrezikut është mesatar.

Gjatë fazës së ndërtimit - Aktivitetet që mund të kenë ndikim në cilësinë e ajrit janë:

- (i) gjenerimi i pluhurit nga aktivitetet e ndërtimit dhe
- (ii) emetimet në ajër nga makineritë e ndërtimit (makineria e rëndë, etj.).

Ekspozimi ndaj pluhurit dhe emetimeve të tjera të gazrave mund të ndikojë në shëndetin e banorëve vendas dhe të punëtorëve të ndërtimit. Megjithatë, madhësia e ndikimit në cilësinë e ajrit është e ulët dhe shtrirja në zonë është e lokalizuar. Kohëzgjatja e ndikimit do të jetë afatshkurtër, gjasat klasifikohen si mesatare dhe niveli i rrezikut është mesatar.

Gjatë fazës së operimit - Faza e funksionimit të Impiantit Diellor FV dhe linjës së transmetimit nuk paraqet ndonjë rrezik që lidhet me emetimet në ajër. Pas fazës së ndërtimit dhe gjenerimi i trafikut është minimal, i kufizuar në funksionimin e përditshëm të Impiantit FV, vizitat e herëpashershme në pjesët e linjës për të ndërmarrëaktivitete të inspektimit dhe mirëmbajtjes. Ndikimet në lidhje me prodhimin e pluhurit dhe emetimet e automjeteve nuk janë të konsiderueshme. Automjeteve të mirëmbajtjesdo t'u kërkohet të ndjekin rrugët e përcaktuara të hyrjes. Rëndësia e përgjithshme e ndikimit për këtë fazë është e papërfillshme.

7.1.4. Ndikimet e zhurmës

Faza parandërtimeve – nivele të ngritura të përkohshme të zhurmës nga pajisjet dhe trafiku i automjeteve gjatë mobilizimit të pajisjeve dhe personelit në vend. Nivelet e zhurmës do të jenë kalimtare dhe të lokalizuara dhe pa ndikime të theksuara.

Gjatë fazës së ndërtimit - Zhurmat dhe dridhjet gjatë fazës së ndërtimit mund të vijnë nga aktivitete të ndryshme të punës. Në mënyrë tipike, kjo përfshin aktivitetet e ndërtimit, përgatitjen e bazave për impiantin diellor FV dhe instalimin e strukturave të nevojshme, mbushjen dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, lëvizjet e automjeteve, pajisjeve dhe personelit, etj.

Aktivitetet e ndërtimit mund të gjenerojnë zhurmë dhe dridhje nga shtyllat metalike të ngulitura në vend. Megjithatë, ky projekt nuk përfshin aktivitete që gjenerojnë nivele të larta zhurmash/dridhjeshe si guroret. Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive është i kufizuar në pajisjen e montimit të shtyllës.

Gjatë fazës së operimit - Gjatë fazës operationale të Projektit nuk do të ketë aktivitete pune përveç ndonjë punimi mirëmbajtje të nevojshëm për impiantin diellor FV dhe linjëne transmetimit. Punimet e mirëmbajtjes parashikohet të jenë të vogla dhe afatshkurtra, prandaj nuk ka pothuajse asnjë ndikim që lidhet me emetimet e zhurmës dhe dridhjeve.

7.1.5. Ndikimet në peisazh

Faza e parandërtimit - gjatë kësaj faze do të ketë ndryshime të konsiderueshme të peizazhit vizual ekzistues për shkak të humbjes së bimësisë dhe habitatit natyror. Madhësia e ndikimit konsiderohet mjaft e theksuar.

Gjatë fazës së ndërtimit - Gjatë fazës së ndërtimit pritet të ketë ndikime domethënëse në ndryshimin permanent të peizazhit të zonës, i cili do të zgjasë sa jetëgjatësia e projektit. Peizazhi do të ndikohet nga prania e mjeteve punuese në vend; nga ndërtimi i godinës së përcjelljes së energjisë; nga vendosja e çdo lloji padisje tjetër në funksion të impiantit FV.

Gjatë fazës së operimit - Efektet e ndryshimit të peizazhit do të jenë prezentë deri në kohëzgjatjen e veprimtarisë së impiantit FV. Ky efekt do të zbutet kur toka e propozuar për projektin do të nënshtrohet rehabilitimit pas përfundimit të operimit të impiantit dhe dekomisionimit të tij.

Faza e çmontimit – pas përfundimit të ciklit të projektit apo për ndonjë arsye tjetër, komponentët përbërës të impiantit do të largohen dhe ndikimet vizuale do të kthehen në gjendjen fillestare dhe me këtë kthehet rehatia vizuale.

7.1.6. Mbeturinat e ngurta

Faza e parandërtimit - mbetjet e krijuara do të përfshijnë mbetjet gjatë gërmimit dhe bimësinë e pastruar. Gjatë pastrimit të vend-punishtes, mbetjet do të grumbullohen në zonat të caktuara para se ato të largohen nga aty. Menaxhimi dhe trajtimi jo i duhur i mbetjeve të ngurta mund të çojë në paraqitjen e erozionit dhe llumëzimin e trupave ujorë sipërfaqësor.

Faza e ndërtimit - mbetjet e ngurta të cilat gjenerohen nga të punësuarit në vend- punishte si mbetje ushqimore. Mbetjet e tjera të cilat gjenerohen nga aktivitetet e ndërtimit dhe instalimit përfshijnë paketimin, hekurishtet dhe dheun e kontaminuar nga derdhjet e karburanteve dhe lubrifikantëve të ndryshëm. Mundësia e ndikimit është e lartë dhe ashpërsia është e moderuar pasi efekti është i kufizuar në vendin e projektit dhe duke pasur parasysh kontrollet që duhen vendosur në përputhje me planin e menaxhimit të mbetjeve të ndërtimit.

Faza operative - në përgjithësi, funksionimi dhe mirëmbajtja e impiantit diellor do të prodhojë mbeturina të papërfillshme të ngurta.

Faza e çmontimit - gjatë fazës së çmontimit, mbetjet e ngurta të krijuara do të përfshijnë mbetjet dhe mbeturinat e betonit, hekurishtet, mbetjet e prishjes, mbetjet e rrezikshme (karburant dhe naftë) dhe dheun e kontaminuar. Mundësia e ndikimit është e lartë dhe ashpërsia është mesatare.

7.1.7. Ndikimet në burimet ekologjike

Faza e parandërtimit - ndikimet e mundshme në vegjetacion përfshijnë heqjen e bimësisë, shkurreve dhe drunjëve eventual kudo që paraqitet nevoja gjatë pastrimit të zonës dhe shndërrimit të habitateve natyrore në një mjedis industrial (humbja e habitateve). Aktivitetet e përgatitjes së lokacionit pritet të rezultojnë në ndikime mesatarisht të rënda në habitatet dhe burimet biologjike në vende të ndryshme në të gjithë zonën e projektit. Rreziku i ndikimit konsiderohet i moderuar me tendencë ka e larta. Pastrimi i zonës do të shkatërrojë gjithashtu habitatin e kafshëve të egra dhe do të shkaktojë migrim jashtë zonës së projektit. Disa nga kafshët e egra të zhvendosura mund të kthehen në zonat përreth zonës pas ndërtimit.

Faza e ndërtimit - gjatë ndërtimit, dëmtimet në tokë gjatë aktivitetëve të tilla si gërmimi dhe hapja e kanaleve, përbën rrezik për vegjetacionin natyror dhe rrit rrezikun e erozionit. Ky shqetësim mund ta lërë vendin të prekshëm ndaj pushtimit të bimëve të huaja. Për më tepër, zhurma nga prania e punëtorëve dhe angazhimi dhe funksionimi i makinerive të rënda ka të ngjarë të përbëjë një shqetësim për speciet e kafshëve të egra që çojnë në migrimin e tyre nga zona. Rëndësia e ndikimit konsiderohet e moderuar.

Faza operative - bimësia do të ndryshojë nga lloji aktual bujqësor në bimësi peizazhi të krijuar nga njeriu. Heqja e bimësisë nga toka dhe lirimi i tokës së sipërme mund të çojë në tokë erozioni. Megjithatë,

ndikime të tilla do të kufizohen kryesisht në vendin e projektit gjatë periudhave fillestare të fazës së ndërtimit. Mundësia e ndikimit të fazës së funksionimit në bimësi është e papërfillshme dhe niveli i ashpërsisë/rrezikut është i papërfillshëm. Ndikimi i funksionimit të impiantit në jetën e faunës përfshin zhurmën dhe reflektimet nga panelet diellore ndërsa ndikimet nga linja e transmetimit mund të rezultojnë në vdekshmërinë e shpendëve përmes goditjes elektrike. Kjo do të shqetësonte habitatet e kafshëve të egra dhe do të çonte në migrimin e mëvonshëm të kafshëve të egra nga zona. Mundësia e këtyre ndikimeve është mesatare, zona e ndikimit është e lokalizuar dhe ashpërsia e ndikimit në jetën e egër konsiderohet e moderuar.

Faza e çmontimit - restaurimi i zonës gjatë dekomisionimit do të përfshijë restaurimin e mbulesës vegetative dhe rimbushjen e tokës, pjesës së sipërme pasi të jenë demontuar të gjitha komponentët e impiantit diellor. Rëndësia e këtyre ndikimeve mund të konsiderohet e ulët pasi humbja e habitateve nuk mund të zbutet plotësisht ose të rikthehet në gjendjen fillestare.

7.1.8. Trafiku/Transporti

Faza e ndërtimit – zhvillimi i projektit kërkon dhe rrit nevojën e transportit, çoftë të materialeve dhe të punëtorëve, gjë që do të sjellë rritjen e fluksit të trafikut, emetimet epluhurit dhe bllokimin e mundshëm të trafikut. Një plan i menaxhimit të trafikut do të zbatohet për të minimizuar pengesat për përdoruesit e rrugës dhe banorët. Mundësia e shfaqjes së pengesave në trafik është e lartë, me ndikime të moderuara, por me rrezikshmëri të theksuar.

Faza operative – manifestohet me ndikime të vogla. Kryesisht do të kemi qarkullim të automjeteve të punëtorëve.

7.1.9. Ndikimet socio-ekonomike

Faza e ndërtimit - gjatë fazës së ndërtimit do të ketë ndikime pozitive në aspektin socioekonomik, sepse zbatimi i këtij projekti krijon vende të reja të punë, e shumica e tyre do të jenë banor të zonës. Ky ndikim ka të ngjarë të ketë efekte minimale për shkak të numrit relativisht të vogël të mundësive lokale të punësimit.

Faza operative - projekti nuk kërkon shume punëtorë gjatë fazës së funksionimit pasi panelet diellore janë projektuar të funksionojnë vazhdimisht dhe pa mbikëqyrje. Kështu, ndikimi social gjatë fazës operative është i papërfillshëm,

8. MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

8.1. Masat e mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së projektit

Masat parandaluese të mbrojtjes së mjedisit duhet të zbatohen që në procedurat e planifikimit hapësinor, përkatësisht gjatë fazës së projektimit që nënkupton fazën e parë të përgatitjes së projektit, ku në këtë fazë arrihen mundësitë më të mëdha për mbrojtjen e mjedisit. Para ndërtimit të parkut të energjisë me erë, duhet të zbatohen këto masa mbrojtëse për mjedisin.

8.1.1. Masat e përgjithshme të mbrojtjes

Para fillimit të ekzekutimit të punëve duhet të përgatitet një projekt i organizimit të vend-punishtes. Ky projekt i organizimit të punëve është edhe një ndër kërkesat ligjore për marrjen e lejes ndërtimore. Përmes këtij plani do të përcaktohen vendet ku do të vendoset dheu i gërmuar, hapësira për automjete dhe makineritë ndërtimore (mirëmbajtje dhe parkim), depozitimi i materialit ndërtimor, etj. Pjesa tjetër e tokës së gërmuar duhet të transportohet në çdo vend në marrëveshje me organet e Komunës së Drenasit.

8.1.2. Masat e mbrojtëse së tokës

Për të siguruar që ndikimet e mundshme të minimizohen, Kontraktorit do t'i kërkohej të përgatisë planet dhe deklaratat e metodave si më poshtë:

- Plani i kampit të punëtorëve duke përfshirë të gjitha masat e propozuara parandaluese për të shmangur ndikimet negative në mjedisin pritës (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, toka, ajri, vendbanimet njerëzore);
- Plani i menaxhimit të ujërave të zeza për sigurimin e tualeteve sanitare si dhe për grumbullimin dhe largimin e duhur të ujërave të zeza për të mbrojtur nga ndotja e rrjedhave ujore dhe ujërave nëntokësore;
- Plani i menaxhimit të mbetjeve që përfshin sigurimin e kontejnerëve të mbeturinave, grumbullimin dhe depozitimin e rregullt në mënyrë higjienike dhe propozimin e landfillit për lloje të ndryshme mbetjesh (si p.sh. mbeturinat shtëpiake, gomat e përdorura etj.) në përputhje me rregullat dhe normat në fuqi;
- Përshkrimi dhe shtrirja e vendit të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe makinerive dhe objekteve për ruajtjen e karburanteve dhe vajrave. Këto objekte duhet të izoloohen me një shtresë të papërshkueshme nga uji për të parandaluar ndotjen e tokës;
- Këto plane do të miratohen nga inxhinieri përgjegjës përpara fillimit të punimeve të ndërtimit.

8.1.3. Masat e mbrojtjes së ajrit

Mënyra më efektive për të menaxhuar dhe parandaluar prodhimin e pluhurit dhe emetimet nga automjetet dhe trafiku është përmes kontrollit efektiv të burimeve të mundshme. Masat specifike të zbutjes dhe menaxhimit për të siguruar që këto burime të minimizohen kontraktorit do t'i kërkohej nga sa renditen më poshtë:

- Spërkatja e rrugëve dhe hapësirave punuese për të kontrolluar gjenerimin e pluhurit;
- Sillni rërë ose zhavorr kur është e nevojshme;
- Sigurimi i përfundimit të shpejtë të punimeve dhe pastrimi adekuat i vend punishtes pas përfundimit;
- Riparoni rrugët që janë në gjendje të keqe kur përdoren për të transportuar materiale për të shmangur krijimin e pluhurit;

- Pastroni rrotat dhe pjesën e poshtme të kamionit përpara se të largoheni nga vendi. Nisur nga përmasat e punimeve dhe makinerive, kalimi nuk do të jetë i konsiderueshëm. Megjithatë, për të maksimizuar përfitimin e projektit, kontraktori duhet të sigurojë që të gjitha pajisjet dhe mjetet e përdorura për ndërtim janë në gjendje të mirë dhe të irëmbajtura;

8.1.4. Masat e mbrojtjes së zhurmës

Duke qenë se zona e projektit është kryesisht jashtë qytetit të Drenasit dhe fshatit Gllanasellë, nuk parashikohen ndikime të zhurmës. Megjithatë, punëtorët duhet të pajisen me pajisje të përshtatshme për mbrojtjen nga zhurma. Megjithatë, zhurma e shkaktuar do të sigurojë që të merren masat e mëposhtme:

- Sigurimi i informacionit paraprak për banorët vendas për punimet
- Nuk ka punime ndërtimore gjatë natës
- Sigurimi i pajisjeve mbrojtëse për punëtorët (tapa veshi) në zona ndërtimi me zhurmë.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është transporti i materialit për në dhe nga punishte. Rrugët janë të ngushta dhe përgjithësisht në gjendje të keqe. Për të shmangur problemet dhe situatat e pakëndshme si rezultat i transportit të materialit është e nevojshme:

- Programoni dërgesën e materialit në bashkëpunim me autoritetet lokale
- Të mos kryejë aktivitete transporti natën; ato duhet të kufizohen në orët e ditës dhe jashtë pikut
- Edukimi i shoferëve; shpejtësia është e kufizuar në 20-25 km/h dhe nuk duhet të përdoren bori.
- Caktoni një vend parkimi për makineritë dhe automjetet ku parkohen kur nuk punojnë; parkimi në rrugë nuk do të lejohet pasi mund të prishë qarkullimin. Sa i përket dridhjeve, kompaktori mund të gjenerojë dridhje të konsiderueshme. Zonat e banuara pranë kantierit do të preken përkohësisht nga punimet e gërmimit dhe ngjeshjes.

8.1.5. Masat për mbrojtjen e biodiversitetit

Për të minimizuar dëmtimin e faunës në zonë, sugjerohet një kombinim masash. Konkretisht investitorit do t'i kërkohet të:

- Minimizimi i humbjes së gjelbërimit nga aktivitetet e ndërtimit dhe kufizimi i lëvizjes në minimum;
- Minimizoni shkatërrimin e folesë;
- Parandalimi i kapjes dhe tregtisë së kafshëve;
- Të ndalohet mbledhja e druve të zjarrit nga zonat e punës;
- Minimizoni dëmtimet në rrugët ujore nga punimet tokësore dhe depozitimi i papërshtatshëm i mbetjeve.

9. PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

9.1. Hyrje

Ky kapitull paraqet nje informacion me te thjeshtuar te gjetjeve nga raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis per projektin “ Panel solar- Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp“ ne Gllanaselle, Komuna Drenas.

Në këtë seksion do të paraqiten;

- nje pershkrim me i thjeshte i zhvillimit te projektit per publikun e interesuar;
- pjesa ligjore mbi te cilen janë vleresuar veprimet në mjedis të këtij projekti;
- analiza e alternativave te parapame për ndërtimin e panelit solar në zonat më të përshtatshme për të;
- gjendja ekzistuese mjedisore e lokacionit ku do te zhvillohet projekti;
- ndikimet e mundshme në mjedis të veprimitarisë së projektit;
- masat zbutese/parandaluese në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi për të minimizuar ndikimet potenciale në mjedis.

9.2. Përshkrimi i projektit

Projekti “**Parku Solar 70.4 MWp**” do të zbatohet në Komunën e Drenasit, më saktësisht në zonen kadastrale te GLLANASELLËS me keto karakteristika gjeografike;

- Gjerësia: 42° 68”
- Gjatësia: 20° 92”
- Lartësia: 653 m

Zonat kadastrale në të cilat shtrihet projekti janë si më poshtë ;

Njësia Kadastrale P-70315014-00185-4, S=368123m², arë, klasa 6

Njësia Kadastrale P-70315014-00208-0, S=996 m², arë, klasa 5

Njësia Kadastrale P-70315014-00209-0, S=6904m², arë, klasa 5

Njësia Kadastrale P-70315014-01380-1, S=253794m², arë, klasa 5

Njësia Kadastrale P-70315014-01380-3, S=140212m², arë, klasa 5

Për këto njesi, investitori ka lidhur marrëveshje kontraktuale për shfrytëzimin e tyre me pronaret respektiv ne dobi te zhvillimit dhe ndertimit te impiantit diellor i cili do te prodhoj energji .

Fshati Gllanaselle paraqet një zonë të favorshme të rrafshet e me rrezatim diellor vjetor të mire. Rreth zonës së projektit nuk ka zona të banuara , si dhe infrastruktura rrugore paraqitet mjaft e mire duke e bërë të favorshme transportin dhe levizjen e mjeteve në këtë lokalitet. Të gjitha këto karakteristika bazë, e bejnë këtë lokacion një zgjidhje optimale për këtë veprimtari.

E gjithë hapësira e planifikuar për zhvillimin e projektit kap një sipërfaqe prej 77 ha. Ngastrat e mësipërme janë tokë e klasit të pestë dhe te gjashte, në pronësi private, për të cilat investitori ka krijuar raporte kontraktuale për shfrytëzim e tyre (kontratë për qiramarrje).

Aplikanti propozon të prodhojë energji elektrike nga burimet e energjisë diellore duke përdorur panele fotovoltaike. Energjia e prodhuar nga keto panele llogaritet afersisht 70.4 MWp. Ose ndryshe nje prodhim energjie vjetore prej 95.9GWp. Për sa i përket alternativave të teknologjisë së energjisë diellore, vetëm teknologjia fotovoltaike është e përshtatshme për zonën e propozuar.

9.3. Baza ligjore mbështetëse për hartimin e VNM-se

Kosova ka një legjislacion specifik që shtron nevojën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Ligji i vitit 2023 për mbrojtjen e mjedisit parashikon disa kërkesa, përfshirë kërkesën për të kryer një VNM dhe për të marrë një leje mjedisore përpara fillimit të projektit.

Për hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin **“Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp”** në Gllanaselle – Drenas është marrë për bazë legjislacioni kombëtar në fuqi.

Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.

Kjo baza ligjore permban ligjet si me poshte:

- LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS
- LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
- LIGJI NR. 08/L-025 2020 PER MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA (SHFUQIZON LIGJIN Nr. 03/L- 160
- LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA (2008)
- LIGJI Nr. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES(09.11.2010)
- LIGJI NR. 05/L-085 PËR ENERGIJË ELEKTRIKE (21.07.2016)
- LIGJI PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË Ndryshohet/Plotësohet nga LIGJI NR. 08/L-123 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME RACIONALIZIMIN DHE VENDOSJEN E VIJAVE LLOGARIDHËNËSE TË AGJENCIVE EKZEKUTIVE
- LIGJI NR.08/L-087 PËR RREGULLIMIN E TOKËS rregullon dhe ploteson NR.04/L-040 (30.08.2022)
- LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE
- UDHEZIM ADMINISTRATIV 04/2022 PER LEJE MJEDISORE

9.4. Karakteristikat e mjedisit fizik të zonës së projektit.

Territori i komunës së Drenasit , shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit dhe është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Komuna e Drenasit ka një sipërfaqe prej 275,63 km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë. Pjerrësia e terrenit është 10 – 35 %. Gjerësia gjeografike ku shtrihet komuna është 42° 32”, gjatësia gjeografike është 20° 64”.Territori i komunës së Drenasit nuk është uniform; në përgjithësi është i përbërë nga zona të rrafshëta, kodrinore dhe malore. Në pjesën qendrore shtrihet lugina e Drenicës, në lindje të së cilës shtrihen Çiçavica, Goleshi dhe Blinaja, ndërsa në perëndim Caraleva, Drenica dhe Kosmaçi. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër”.

E veçanta tjetër e kësaj treve është miniera dhe shkëmborja e “Feronikelit”, si dhe disa gurore. Nëpër këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbicë, uji i të cilave shfrytëzohet për nevojat e ujitjes së tokave bujqësore. Kjo komunë, në pikëpamje të ndërlidhjes tokësore lidhet me pjesët tjera të Kosovës me anë të hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë – Bushat (Komoran)-Pejë, dhe rrugët ndër komunale Shalë- Lipjan dhe Bushat-Drenas-Skenderaj.

Duke qenë një zonë me pasuri natyrore të shumta, nga të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore në Komunën e Drenasit, trashëgimia arkeologjike përfshin 7 asete ndërsa ajo arkitekturore përfshin 11 objekte. Duke u bazuar në informata nga kjo Komune, prej 11 objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshin lista e përkohshme, 1 prej tyre është në gjendje të mirë, 1 në proces të ndërtimit, 3 në gjendje mesatare, 5 të dëmtuar dhe 1 fare nuk ekziston.

9.5. Ndikimet e mundshme në mjedis të veprimtarisë së projektit

Energjia solare, duke qenë energji e rinovueshme, përbën një burim të qëndrueshëm energjie, në ndryshim nga ajo e përfituar nga djegia e naftës, gazit apo qymyrit, por edhe ajo hidroelektrike. Megjithatë energjia solare klasifikohet në burimet e rinovueshme të energjisë, pasi nuk shpenzon resurse natyrore, ndërtimi dhe funksionimi ka ndikime në mjedis të cilat duhen analizuar në mënyrë specifike. Ndikimet mund të ndahen në ndikime gjatë ndërtimit dhe ndikime gjatë funksionimit.

Ky projekt nuk pritet të ketë ndikime negative sinjifikante në mjedis pasi teknologjia e përdorur dhe aktiviteti i tij janë miqësorë me mjedisin. Çka do të thote se vetëm gjatë fazës së ndërtimit të projektit, kryesisht gjatë kryerjes së punëve për vendosjen ose montimin e paneleve solare do të ketë shqetësime të vogla që lidhen me pamjen vizuale të zonës;

zhurma gjatë kohës së montimeve dhe hapjes së rrugëve të aksesit në zonën e projektit;

gjenerimi i lehtë i pluhurave në ajër gjatë kohës së levizjes së makineve punuese në zonë ;

gjenerimi i mbetjeve në punishte ;

9.6. Masat zbutëse për minimizimin e ndikimeve

Masat parandaluese të mbrojtjes së mjedisit duhet të zbatohen që në procedurat e planifikimit hapësinor, përkatësisht gjatë fazës së projektimit të projektit, që nënkupton fazën e parë të përgatitjes së projektit, ku në këtë fazë arrihen mundësitë më të mëdha për mbrojtjen e mjedisit. Parandalimi i ndërtimit të parkut fotovoltaik , duhet të zbatohen këto masa mbrojtëse për mjedisin.

Para fillimit të ekzekutimit të punëve duhet të përgatitet një projekt i organizimit të vend-punishtes. Ky projekt i organizimit të punëve kërkohet është edhe një ndër kërkesat ligjore për marrjen e lejes ndërtimore. Përmes këtij plani do të përcaktohen vendet ku do të vendoset dheu i gërmuar, hapësira për automjete dhe makineritë ndërtimore (mirëmbajtje dhe parkim), depozitimi i materialit ndërtimor, etj. Pjesa tjetër e tokës së gërmuar duhet të transportohet në çdo vend në marrëveshje me organet e Komunës së Drenasit .

Bazuar në ndikimet e mundshme në mjedis të këtij projekti , në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis janë dhënë masat adekuate të cilat minimizojnë efektet negative dhe sigurojnë një mbrojtje të mirë të mjedisit përreth.

10. PLANI I MENAGJIMIT MJEDISOR

Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM) është përgatitur për të menaxhuar ndikimet mjedisore përmes veprimeve specifike lehtësuese të kërkuara për zbatimin e Projektit solar në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare në fuqi. Plani i Menaxhimit Mjedisor ofron një përmbledhje të kushteve bazë mjedisore në zonën e propozuar të projektit, përmbledh ndikimet e mundshme që lidhen me punimet e propozuara të ndërtimit dhe përcakton masat e menaxhimit të kërkuara për të zbutur çdo ndikim të mundshëm.

Ky plan do të zbatohet nga kontraktori i cili do të autorizohet nga MMPHI për projektin. Objektivat e PMM janë:

- Minimizimi i çdo ndikimi negativ mjedisor, social dhe shëndetësor që rezulton nga aktivitetet e projektit;
- Parandalimin ose kompensimin e çdo humbjeje të personave të prekur nga projekti;
- Kryerja e të gjitha aktiviteteve të projektit në përputhje me ligjet përkatëse të Kosovës;
- Rritja e rezultateve pozitive mjedisore dhe sociale;
- Të sigurohet që Plani Mjedisor të jetë i realizueshëm dhe me kosto efektive;
- Të veprojë si një plan veprimi për të siguruar që masat zbutëse të projektit janë zbatuar dhe monitoruar siç duhet; dhe
- Siguron që të gjitha shqetësimet e palëve të interesuara janë adresuar.

11. PËRFUNDIMET

Pas punimit të këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis , mund të konkludohet se “Parku Solar – Impianti Fotovoltaik 70.4 MWp” në Gllanaselle – Drenas , nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve. Gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatojmë se ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm. Gjithashtu “Parku Solar – Centrali Fotovoltaik 70.4 MWp” n në Gllanaselle – Drenas do të ketë ndikime pozitive socio ekonomike për shkak se do të punësohen punëtorë. Efektet pozitive janë edhe prodhimi i energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë MMPHI, dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor për “Parku Solar – Centrali Fotovoltaik 70.4 MWp” në Gllanaselle – Drenas, sipas kërkesës së aplikuesit.

Shtojcat:

- 1. Pëlqimi i Kuvendit komunal
- 2. Certifikata e regjistrimit të biznesit – ARBK
- 3. Informatat per Biznesin
- 3. Fletët Poseduese dhe kopjet e planeve të parcelave
- 4. Plani i Rilevimit te terrenit nga gjeodeti i licencuar
- 5. Koordinatat e vijes ndertimore nga gjeod. i licencuar
- 6. Kontratat për shfrytëzimin e ngastrës për qiramarrje
- 7. Raporti Tekniko – Financiar - Dëshmi për vlerën financiare investuese

Referencat :

- ✓ *Plani Lokal I Veprimit ne Mjedis 2020-2024*
- ✓ *Plani Zhvillimor Kumunal Drenas 2020-2028*
- ✓ *Raporti I gjendjes se mjedisit ne Drenas*
- ✓ *Studime mbi biodiversitetin e Drenasit ; Halil Ibrahim , Agim Gashi , Astrit Bilalli , Milaim Musliu , Linda Grapci Kotori , Ferdije Zhushi Etemi*
- ✓ *University of Prishtina "Hasan Prishtina", Faculty of Mathematics and Natural Sciences, Department of Biology, Prishtina, Kosovo*
- ✓ *University of Prishtina, Faculty of Mathematics and Natural Sciences, Department of Biology, Prishtina, Kosovo*
- ✓ *University of Peja "Haxhi Zeka", Faculty of Agribusiness, Klinë, Kosovo Corresponding author: Agim Gashi (agim_gashi@yahoo.com)*

¹https://me.rks-gov.net/repository/docs/Strategjia_e_energji_2017-26_-.pdf